

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



**NJË BIOGRAFI
E SHKURTËR E JETËS
SË IMAMËVE**

Tiranë, 2020

Titulli i librit: Një biografi e shkurtër e jetës së Imamëve

Autori: imam Ali Khamenei

Përktheu: Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Korrekttoi: Vjollca Karaj

Përgatiti për shtyp& Kopertina: Sabrie Feza

Botues: Shoqata FLLADI

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

HYRJE

Një nga çështjet më të rëndësishme në jetën e njeriut është që jo vetëm të njohë, të dijë se me kë të lidhet, por edhe të njohë mirë cilësitë e këtij personi.

Ajo që thuhet, se njerëzit janë armiq të asaj që nuk e njohin, është e vërtetë dhe i përshtatet vendit tonë.

Nëse njeriu nuk e di se pas kujt lidhet si udhëheqës, ose e di, por e ka injoruar, ose e ka vlerësuar gabim, atëherë do të bëhet armiku i tij, e ndien apo s'e ndien.

Ne e njohim mirë udhëheqësin tonë, ai është nga familja e Ehli Bejtit. Por a i kemi njohur ne mirë ata? A u kemi dhënë atyre hakun në vlerësimin që u bëjmë?

Ne, kemi nevojë për një vlerësim real, që të kemi njohuri të sakta rreth tyre.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Do të ketë njerëz që do të më duan mua dhe për dashurinë time do të hyjnë në zjarr, ashtu si do të ketë njerëz që do të më urrejnë mua, deri sa të hyjnë në zjarr nga urrejtja për mua.”*¹

Po ashtu ka thënë: *“Dy burra vdesin për mua: një i dashuruar marrëzisht me mua, edhe me atë që nuk është tek unë dhe një njeri që më urren mua për të më venitur mua.”*²

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë të vërtetën, në hiperbolizimin e dy ekstremeve për të dashurit dhe urreyesit e tij.

Dashuria e tyre për të ka arritur deri aty sa e kanë ngritur atë në piedestalin hyjnor të të adhruarit, kurse urrejtja e disave ka arritur deri aty, sa e kanë gjykuar si të dalë nga feja.

Të njohësh Ehli Bejtin, nuk është vetëm një punë intelektuale apo zemërgjerësie, përkundrazi kjo e tejkalon njohurinë e qëllimeve të tyre, rrugëtimin në të vërtetën e tyre. Ata janë shembulli dhe modeli për t’u ndjekur.

Udhëheqësi ynë, imam Khamenei thotë: “Ne duhet ta shikojmë jetën e Imamëve si një shembull dhe model për

1 “Jenabiul Meuddeti”, vëll 2, f. 181.

2 Shejkh Tusij, “El Emaalij”, f. 256.

t'u ndjekur në jetën tonë, jo thjesht si kujtime të vyera dhe madhështore që kanë ndodhur në histori. Kjo përmbushet vetëm me interesim dhe përqendrim në metodën politike të biografisë së këtyre njerëzve të mëdhenj."

Në të vërtetë, zinxhiri i ngjarjeve që kanë ndodhur në historinë e Imamëve, është një zgjatim i vijës së luftës dhe përballjes që ka vazhduar përgjatë dyqind e pesëdhjetë viteve me probleme nga më të ndryshmet. Kjo ka ndodhur për disa arsye. Po i listojmë ato.

Së pari: Qëllimi i saj ka qenë sqarimi i Islamit, komentimi i Kur'anit dhe paraqitja e panoramës së qartë të dijeve islame.

Së dyti: Qartësimi i çështjes së imamatit dhe qeverisja politike në shoqërinë islame.

Së treti: Përpjekja për ta formësuar atë në shoqëri dhe për të realizuar qëllimin e të Dërguarit madhështor (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe të të gjithë Profetëve, domethënë: instalimin e drejtësisë dhe largimin e atyre që e barazojnë veten me Allahun; përcaktimin e frerëve të administrimit të jetës në dorën e kalifëve të Allahut dhe robëve të Tij punëmirë.

Një nga qëllimet e larta të Imamëve, është formimi i një qeverie hyjnore e të drejtë.

Nuk ka asnjë dyshim se të gjithë Imamët tanë, pa asnjë përjashtim, kanë luftuar për hir të formimit të qeverisë së drejtësisë hyjnore.

Në këtë libër ka pjesë të shkëputura nga thëniet e udhëheqësit tonë, imam Khameneit (*Allahu ia zgjatë jetën!*) për Ehli Bejtin. Lidhja jonë me ta duhet të jetë më e fortë.

Ne, pa dashurinë, nuk mund të përparojmë në këtë kryengritje. Ne, në mendimin islam, kemi besueshmërinë më të lartë të dashurisë. Ajo është dashuria për Ehli Bejtin.

Ne e kemi për detyrë të kujdesemi për çështjen e Ehli Bejtit, sepse është një prej çështjeve më të rëndësishme dhe më të mëdha të Islamit. Ajo është e para në radhë, nisur nga çështjet e kësaj feje të shenjtë.

Nisur nga kjo premisë, ne grupuam fjalët e udhëheqësit, nga fjalime të ndryshme që ai ka bërë.

Shpresojmë të tubojmë edhe për Ehli Bejtin dhe të ngrihemi lart shpirtërisht, që të jemi zbukurim për ta dhe jo barrë e tyre.

PJESA E PARË

RRUGA E EHLI BEJTIT

- *Pikëpamje të gabuara*
- *Pikëpamja e saktë*
- *Filozofia e imamatit*
- *Kuptimi i imamatit*
- *Rruga e përgjithshme e Imamëve*
- *Synimet e qeverisë islame*

Pikëpamje të gabuara

Një pjesë kanë shprehur pikëpamje të gabuara për Imamët dhe nuk u kanë dhënë vlerësimin që meritojnë. Për këtë çështje flet udhëheqësi ynë dhe e nis fjalën e tij me zbërthimin e figurës së imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ka dy pikëpamje të gabuara për imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) që burojnë prej dy lloje mendimesh. E çuditshme është se këto dy pikëpamje përafrohen në formë dhe në përmbajtje. Madje ne mund të themi se të dyja pikëpamjet pajtohen plotësisht në disa akse.

Pikëpamja e parë, është pikëpamja e shi'itëve (ndjekëse) të imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) në thënie e jo në veprime. Kjo pikëpamje përmbledhet si vijon:

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte në dispozicion kushte e situata që asnjë imam nuk i ka pasur më parë dhe asnjë nuk do t'i ketë më pas tij. Ai arriti t'i shfrytëzojë ato për të përhapur ligjet e fesë, që t'ia hapë portat e mexhllisit të tij studentëve të dijes. U ul në shtëpinë e tij dhe ua hapi gjoksin nxënësve, sfidoi mësimdhënien dhe përhapri njohuritë. Prej tij është transmetuar dija nga të gjithë nxënësit e tij të dijes dhe thirrësit e të vërtetës. Në mexhllisin e tij kanë marrë pjesë katër mijë nxënës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përballur në debat me njerëz që i përkisnin mendimeve të ndryshme, duke iu kundërpërgjigjur heretikëve, materialistëve dhe ateistëve, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet nxënësve.

Gjithashtu, këta njerëz që bartnin këtë pikëpamje, kanë thënë se imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), duke u kujdesur për të ruajtur vazhdimësinë e këtij projekti shkencor, është detyruar të mos ndërhyjë në politikë, kështu që nuk ka pranuar asnjë punë politike, përkundrazi dhe për më tepër, ai zgjodhi një rrugë që ecën në përputhje me politikën e kalifëve të kohës së tij, për t'i kënaqur ata dhe për të larguar çdo lloj dyshimi që do të mund të sillej rrotull aktivitetit të tij.

Prandaj nuk është përballur ballë për ballë. Këtë ua ndaloi edhe të tjerëve, për t'u përballur me ta. Kushtet mund ta detyrojnë që ai të shkojë tek ata dhe të marrë medaljen dhe nderimin e tyre dhe, nëse ndodh që udhëheqësi të ketë krijuar një mendim të keq për të, si rezultat i ndodhisë së lëvizjes revolucionare apo për ndonjë çështje të ngritur nga ndonjë llafazan, imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) do të synojë joshjen e udhëheqësit dhe komplimentimin e tij.

Kjo pikëpamje e paraqet imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) si një dijetar, studiues dhe profesor i madh, prej oqeanit të dijes së tij ka marrë Ebu Hanifja dhe Maliku. Mirëpo, imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndronte shumë

larg çdo lloj rezistence të agresionit të pushtetit ndaj fesë dhe larg çdo gjëje të mirë që ia kërkon atij çështja e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit të së keqes përballë autoritetit mizor dhe zullumqar.

Ai ishte shumë larg revolucionarëve të tjerë, si: Zejd ibn Aliu, Muhamed ibn Abdullahu, Hysejn ibn Ali, madje edhe nga ushtarët luftëtarë të këtyre revolucionarëve!

Kurrë nuk shfaqte kundërshtim kundrejt asaj që ishte e mirë për shoqërinë islame dhe nuk i interesonte fare pasuria që grumbullonin jo vetëm përkrahësit, por as ankesat që kishin bijtë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në malet e Taberistanit dhe të Mazendaranit!

Atij nuk i interesonin as bashkëvuajtësit irakianë e iraniane që vuanin skamjen e urinë, saqë nuk gjenin asnjë gjë për të futur në gojë; as nuk i interesonte ajo me të cilën përballeshin ndjekësit e tij, si: vrasja, torturimi, internimi, kur janë duarbosh nga çdo lloj kënaqësie që njerëzit e zakonshëm të shoqërisë së asaj kohe i shijonin!

Kjo është panorama e imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilën e vizatuan bartësit e pikëpamjes së parë.

Pikëpamjen e dytë e bartin ata që nuk e pranojnë imamatin e imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Është një pikëpamje paragjykuese ndaj Imamit, sikur ai mbante

qëndrim opozitar, moskokëçarës, kur shoqëria mbytej në dhunë.

Shoqëria në kohën e tij vuante jo vetëm dhunën e klasave, por edhe dhunën politike dhe kontrollin e neveritshëm ndaj pasurive të njerëzve, të vetes dhe nderit të tyre. Mbi të gjitha këto, kontrollin e mendjeve të tyre, shpirtrave, mentalitetit dhe ndjenjave të tyre, deri në atë pikë sa populli të kënaqej me të drejtat elementare të njeriut, duke futur këtu edhe aftësinë për të votuar.

Përballë kësaj, mizorët talleshin si të dëshironin me vlerat njerëzore. Ata ndërtonin pallate luksoze, njësoj si kështjella Hamra, shumë afër mijëra rrënojave, ku jetonin njerëzit e thjeshtë e të vobektë.

Në një shoqëri të tillë, të mbushur me ngjyrat e abuzimit dhe të persekutimit, imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i drejtohet hulumtimit, të mësuarit dhe edukimit të studentëve. Gjithë interesin dhe kujdesin e tij e derdhi në diplomimin e fukahave oratorë.

Kjo optikë harmonizohet me optikën perëndimore dhe rolin e tyre në deformimin e imazhit të imamëve. Janë këta orientalistë që erdhën për të mësuar dhe për të vërtetuar fenë dhe historinë islame. Mirëpo, në të vërtetë, ata erdhën për ta futur në kurth Islamin, me qëllim, me dije dhe zgjedhje paraprake, ose pa asnjë qëllim të keq, pasi ata

ishin sipërfaqësorë në hulumtimin e tyre dhe të nxituar në gjykim.

Udhëheqësi imam Khamenei na thotë: “Pikëpamja e dytë, gjithashtu, është dyshuese dhe joshkencore. Ajo i ngjason dispozitave të lëshuara nga orientalistët, qoftë me qëllim, qoftë nga injoranca apo nga shpirti nxitës materialist, që nuk harmonizohet fare me natyrën e ngjarjeve islame.

Ne i kemi dëshmuar me sy ato dispozita të parëndësishme, të ashpra, që burojnë nga një pjesë e orientalistëve kundrejt Islamit dhe Imamëve të Ehli Bejtit. Njëri prej tyre ka folur për imam Hasanin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ka thënë se ai e ka blerë kalifatin me para. Jetën e ka kaluar mes të mirave, grave dhe luksit.

Një orientalist tjetër ka thënë se Islami e ka zhvendosur shoqërinë nga rendi skllavopronare drejt rendit feudal.

Pikëpamja e dytë për të cilën po flasim, pajtohet me thëniet e këtyre orientalistëve në sipërfaqësi, impulsivitet dhe logjikë materialiste.”

Pikëpamja e vërtetë

Udhëheqësi, imam Khamenei thotë: “Tani le të fillojmë me pikëpamjen e tretë, në lidhje me imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*), që është një optikë, nga ku mund të dalë në këtë përfundim secili symprehtë që u referohet burimeve.

Ky inovacion nuk është i veçantë vetëm për jetën e imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), por përfshin të gjithë Imamët e Ehli Bejtit, duke dalluar karakteristikat e punës së secilit prej tyre, sipas kushteve të kohës dhe të vendit.

Ky ndryshim nuk është në përputhje me unitetin e shpirtit të punës publike, realitetit të saj dhe me unitetin e qëllimit dhe objektivit.

Me qëllim që të kuptojmë natyrën e rrugëtimit publik të jetës së Imamëve, së pari, duhet të sqarojmë filozofinë e imamatit.”

Filozofia e imamatit

Udhëheqësi ynë, imam Khamenei thotë: “Që të kuptojmë mirë tubimin publik të jetës së Imamëve, që prej kohës së vdekjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), deri te vdekja e ushtarakut imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*), së pari, e kemi për detyrë të sqarojmë filozofinë e imamatit.

Vija e shkollës së Ehli Bejt, që njihet me emrin e imamatit, elementet thelbësore të të cilit përbëhen prej njëmbëdhjetë individësh, njëri pas tjetrit, përafërsisht gjatë dy shekujsh e gjysmë, nuk është gjë tjetër veçse një zgjatim i profecisë.

Allahu i Madhëruar e dërgoi Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me një metodikë të re për jetën, me një akide të re, me një ligj të ri për marrëdhëniet njerëzore dhe me një mesazh për njerëzimin. Jeta e tij është në një luftë të vazhdueshme dhe mundim pafund, që të çojë në fund rëndësinë e mesazhit që ka marrë mbi shpatulla, për atë kohë sa të jetë në jetë.

Procesi i evokimit duhet të vazhdojë, me qëllim që mesazhi të arrijë shkallët më të larta të parashikuara, duke realizuar kështu objektivat.

Barrën e vazhdimi duhet ta mbajë njeriu më i afërt i bartësit të mesazhit, në të gjitha dimensionet, që të sjellë amanetin në stacionin e sigurt, të mbrojtur, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm.

Këta janë Imamët dhe trashëgimtarët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i të gjithë Profetëve të mëdhenj, sepse bartësit e mesazheve kanë pasur trashëgimtarë dhe mëkëmbës.

Me qëllim që të njohim rëndësinë e Imamit, ne duhet të njohim detyrën e rëndësishme të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Detyrën na e sqaron Kur'ani Famëlartë: **“Ne i çuam të Dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt. Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit, me qëllim që Allahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të Dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”³**

Ky është një nga ato ajete, që nga njëra anë, qartëson arsyen e profecisë, kurse, nga ana tjetër, sqaron detyrën e Profetëve.

3 Sure “El Hadijd”, ajeti 25.

Profetët janë dërguar për të ndërtuar shoqërinë e re dhe për të shkukur rrënjët e korrupsionit dhe të së keqes, për të njoftuar revolucionin ndaj injorancës në kohën e tyre dhe çlirimin e shoqërive të tyre.

Këtë proces ndryshimi na e përkufizon imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në fillimin e marrjes në dorëzim të detyrave të qeverisjes së tij: *“Deri sa ata që ishin poshtë jush, të rikthehen sipër jush dhe ata që janë sipër, të kthehen poshtë...”*⁴

Dhe: *“...të vendos të drejtën dhe të largoj të kotën.”*⁵

Vërtet, ai është procesi i mbrojtjes së një shoqërie në themelin e Teuhidit, drejtësisë shoqërore, nderimit të njeriut, çlirimit të tij, realizimit të barazisë së të drejtave ligjore midis grupimeve dhe individëve; është proces i refuzimit të shfrytëzimit, të tiranisë dhe të monopolizimit, hapjes rrugë së forcave dhe kompetencave njerëzore, nxitjes e arsimimit, mësimdhënies, mendimit dhe të menduarit.

Ai është procesi i ngritjes së shoqërisë, ku zhvillohen brenda saj të gjithë faktorët e përparimit të njeriut në të gjitha dimensionet kryesore, duke e shtyrë qenien njerëzore të ecë drejt rrugës së përsosjes në fushën e historisë.

4 “Nehxhul Belaga”, Hytbeja 16.

5 “Nehxhul Belaga”, vëll. 1; Nga hytbeja e tij, kur shkoi të luftojë popullin e Basras.

Kjo është detyra me të cilën Allahu i Madhëruar i ka dërguar Profetët. Nga kjo dalim në përfundim se imamati, duke e konsideruar si zgjatim të detyrave profetike, ngarkohet me të njëjtat barra.

Qëllimi i imamatit është i njëjtë me qëllimin e profecisë, rruga është e njëjtë, domethënë krijimi i një shoqërie të drejtë islame, në drejtësi dhe përpjekja për të ruajtur rrugëtimin e tij të vërtetë.”

Kuptimi i imamatit

Udhëheqësi, imam Khamenei e zhvendos bisedën rreth kuptimit të Imamatit, duke folur për imam Sexhadin (*Paqja qoftë mbi të!*): “Shikoni se si përfiton imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) nga metodika e tij tërheqëse, kur thotë: ‘Gjëja e parë që të pyesin ata të dy (engjëjt), është për Zotin tënd që ti e adhuroje. Pyetja tjetër që të bëjnë, është për imamin që ke ndjekur pas.’.”⁶

Këtu ai shtron temën e imamatit. Çështja e imamatit, tek Imamët, do të thotë çështje e qeverisë, pasi në gjuhën e Imamëve nuk ka asnjë dallim midis shtetit dhe imamatit, edhe pse këto të dyja kanë kuptime të ndryshme te disa. Këto dy çështje, shteti dhe imamati, në gjuhën e Imamëve, janë një gjë, kurse për sa i përket fjalës “imam”, që ka për qëllim këtu, ka kuptimin e atij njeriu të ngarkuar për udhërrëfimin e njerëzve dhe udhëzimin e tyre për nga aspekti fetar, gjithashtu i ngarkuari për të administruar çështjet dhe problemet e jetës së tyre, për nga aspekti i dynjasë. Me fjalë të tjera, mëkëmbësi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Njerëzit në Iran, në kohën e mëparshme, në kohën e imam Khomenit (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), nuk e kanë

⁶ “El Kafij”, vëll. 8, faqe 73.

ditur mirë kuptimin e vërtetë të fjalës “imam”, kurse sot populli ka nisur ta kuptojë më mirë. Ne themi se imami është udhëheqësi i shoqërisë, pra, ai është njeriu prej të cilit ne mësojmë fenë tonë. Në dorën e tij është administrimi i jetëve tona, duke iu bindur atij në çështjet e fesë dhe në çështjet e dynjasë, që ne i kemi për detyrë t’i veprojmë.

Për fat të mirë, ky kuptim (për imamin) është fiksuar mirë në mendjet e njerëzve, pas revolucionit.

Në botën e Shi’izmit, çështja e rolit të imamit ka pasur një kuptim të gabuar. Në të shkuarën, njerëzit mendonin se imami individualizohet, duke u veçuar në shoqëri dhe ai duhet të administrojë me dorën dhe mundin e tij, problemet e jetës. Kështu, ai lufton dhe bën paqe, punon dhe zbaton vetë çdo kërkesë, personalisht, pasi ai, nga njëra anë, i urdhëron njerëzit dhe ua ndalon atyre dhe, në të njëjtën kohë, është po ai vetë që i zgjidh këto probleme, për të reformuar fenë e tyre.

Edhe sot, kjo çështje i ekspozohet kuptimit të gabuar, aq sa ne filluam të konsiderojmë se imami, në kohën e fshehjes, nuk është veçse një dijetar fetar. Sigurisht që ky është një mendim i gabuar. Fjala “imam” ka kuptimin: i përparuari dhe udhëheqësi, prijësi. Kur imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u fliste njerëzve në Mina dhe Arafat, me fjalët: “O ju njerëz, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë*

mbi të e mbi familjen e tij!) ka qenë imam.”⁷, donte të tregonte se imami është njeriu që merr përgjegjësitë fetare, përgjegjësitë e kësaj bote dhe çështjet e njerëzve.

Në shoqërinë islame, kohët e qeverisjes së Abdul Melik ibn Mervanit dhe në kohën e imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*), kishte një kuptim të gabuar për këtë, sepse imamati i komunitetit, që ishte administrata e çështjeve të jetës së njerëzve, është grabitur nga njerëzit e saj dhe i është dhënë atij që nuk e meritonte, deri aty shkonte puna, sa i vinin epitelin vetes të tyre “imamë” dhe njerëzit i njihnin ata si të tillë.

Njerëzit kanë quajtur me titullin “Imam”, Abdul Melikun dhe para tij, babain e tij dhe para atyre të dyve, Jezidin me të tjerë. Njerëzit i pranuan ata në bazë të asaj se ata ishin komandantët e shoqërisë dhe udhëheqësit e njerëzve.

Kështu, pra, kur imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) thoshte se ti do të pyetesh në varr për imamin tënd, ka dashur të tregojë e të thoshte se a ke zgjedhur imamin e duhur dhe të saktë.

Mos vallë, ai njeri që të udhëheq ty dhe drejton edhe shoqërinë, ku ti jeton, vërtet është një imam? A është ai prej

⁷ “El Kafij”, vëll. 4, f. 466.

atyre njerëzve që Allahu i Madhëruar është i kënaqur prej tij?

Me këtë fjalim, Imami i zgjonte njerëzit, që kjo çështje të ishte e ndjeshme në shpirtin e tyre.

Qëllimi i Imamëve është qëllimi, objektivi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), që është formimi i qeverisjes islame. Këtë kuptim e miraton imami udhëheqës, imam Khamenei: “Pra, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), me anë të betejës dhe luftës, themeloi qeverinë e të drejtës, ku u ndërtua sistemi islam. Pas kësaj, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) luftoi jo vetëm për ta ruajtur këtë sistem, por edhe për vazhdimësinë e tij. Është e palogjikshme të injorohet imami, për këtë temë të rëndësishme, për hir të ndjekjes së rrugës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).”

Rruga e përgjithshme e Imamëve

Udhëheqësi imam Khamenei thotë: “Imamët shi’itë drejtoheshin, njësoj si Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), kah këtij objektivi, pra, drejt ngritjes së një sistemi të drejtë islam, me të njëjtat karakteristika dhe në të njëjtën rrugëtim.

Pas ngritjes së këtij sistemi, përpjekjet drejtohen kah mbrojtjes së kësaj rruge dhe vazhdimësisë së saj.

Po çfarë kërkon ngritja e një sistemi shoqëror apo vazhdimi i marshimit të këtij sistemi?

Së pari, kërkon ideologji të orientuar dhe udhëzuese, prej të cilës të dalë ky sistem dhe ta perifrazojë atë.

Së dyti, ka nevojë për një fuqi ekzekutive, që të bëjë të mundur hapjen e rrugës nga vështirësitë, problemet dhe pengesat, drejt realizimit të qëllimit.

Ne e dimë se ideologjia e Imamëve është Islami dhe Islami është mesazhi i përhershëm i njerëzimit, është një mesazh që bart në brendësinë e tij elemente të përjetësisë së tij.

Po t'i vërejmë me kujdes këto çështje, do të mund të kuptojmë me lehtësi metodikën e përgjithshme të Imamëve të Ehli Bejtit dhe trashëgimtarët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Kjo metodë ka dy anë të lidhura me njëra-tjetrën: e para, lidhet me akiden, kurse e dyta lidhet me marrjen e fuqisë ekzekutive dhe shoqërore.

Në aspektin e parë, përpjekjet dhe mundi i tyre drejtohet kah përhapja e mesazhit, kristalizimi dhe vendosja e tij; zbulimi i devijimeve, që burojnë nga dashakeqët dhe njerëzit e dalë nga feja; deklarata e tezës islame për çështjet e reja, si dhe ringjallja e mësimave të mesazhit që janë varrosur, për shkak të përplasjes me interesat e njerëzve të pushtetit dhe ekzekutivit; qartësimi i gjërave që u janë mbajtur të fshehta mendjeve të zakonshme nga Libri i Allahut dhe tradita e Profetit të Tij.

Pra, detyra e aspektit të parë, përmbledhet me ruajtjen të gjallë të mesazhin islam, një konstrukt i lëvizshëm me kalimin e brezave.

Në anën tjetër, ata përpiqeshin, sikurse e kërkonte situata politike, shoqërore dhe botërore në shoqërinë islame, të përgatisnin kushtet e duhura, që të merrnin sa më shpejt, vetë, frerët e udhëheqjes së qeverisjes së shoqërisë, ose të përgatisnin mjedisin, që të merrnin në dorëzim, në planin afatgjatë, dikë që do të vazhdonte rrugëtimin e tyre në të ardhmen.

Me pak fjalë, ky është, pra, qëllimi i jetës së Imamëve të pastër dhe këto janë hapat, vijat e përgjithshme të qëllimeve të tyre. Për hir të saj kanë jetuar dhe për hir të saj ata ranë dëshmorë.”

Synimet e qeverisë islame

Shumica e njerëzve ka një mendim të gabuar, që Imamët janë asketë, prej atyre njerëzve që kanë braktisur dynjanë, bashkë me problemet e saj, duke u strehuar në kullat e tyre, duke adhuruar Allahun e Lartësuar, i luten atij, të pavëmendshëm ndaj shoqërisë dhe çfarë u ndodh atyre. Atyre nuk u intereson asgjë tjetër pos flakjes së diturisë islame. Ndërsa, për sa i përket zbatimit të kësaj diturie, në realitet, çka do të çojë në formimin e qeverisë islame, për këtë as nuk janë përpjekur fare.

Udhëheqësi i nderuar, imam Khamenei flet rreth kësaj teme dhe miraton se synimet e Imamëve kanë një dimension më të largët, se sa kjo pikëpamje e ngushtë. Ai pyet: “Çfarë synojmë, kur ia atribuojmë Imamëve përballjen apo luftën politike?

Ajo që synohet nga kjo bisedë, është se xhihadi i Imamëve nuk ishte një xhihad diturie, siç janë përplasjet që bëhen midis dy teologëve, që ne e kemi parë përgjatë historisë, njësoj si konflikti midis mutezilitëve dhe esh'arinjve dhe të tjerëve. Synimi i Imamëve në tubimet e tyre të dijes, klasave të mësimave të tyre dhe haditheve, nuk ka qenë vetëm transmetimi i njohurive islame dhe i ligjeve, derisa të themelonin shkollën e tyre të teologjisë dhe të jurisprudencës, përkundrazi synimi i tyre e tejkalon këtë.

Përballja e Imamëve ka qenë një përballje që kishte si qëllim prapavijën politike. Po çfarë është ky synim atëherë?

Synimi është shprehje e formimit të qeverisë islame dhe, sipas vlerësimit tonë, një qeveri hyjnore.

Përpyekja e Imamëve, që prej kohës së ndërrimit jetë të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe deri në vitin 260 hixhri, ishte gjetja dhe themelimi i një qeverie hyjnore për shoqërinë. Ne nuk mund të themi se çdo imam ishte në proces të themelimit të qeverisë në kohën e tij, por mund të themi se qëllimi i çdo Imami përfshinte themelimin e qeverisë së pavarur islame, që mund të ndodhë në të ardhmen e afërt apo të largët.

Pra, qëllimi i themelimit të qeverisë ka qenë gjithmonë drita e syve të Imamëve dhe qëllimi më i lartw i tyre, mirëpo koha e dëshiruar për themelimin dhe ngritjen e saj ndryshon nga një imam te tjetri.

Të gjitha punët që bënin Imamët, pa marrë parasysh çështjet shpirtërore, të cilat synojnë përsosjen dhe lartësimin e shpirtit njerëzor dhe afrimin me Allahun, ishin punë që synonin themelimin e kësaj qeverie islame, kështu që aktivitetet e tyre për përhapjen e diturisë dhe pikëpamjet që ata ngrinin kundër kundërshtarëve të tyre në dituri, politikë, si dhe pozicionimet e tyre në krah të xhematit, si dhe qëndrimi përballë gjithë kësaj, është themelimi i qeverisë islame.”

PJESA E DYTË

IMAMËT DHE SHI'ITËT

- *Imamët janë për të gjithë njerëzit*
- *E qara*
- *O ju besnikë, mos u dëshpëroni!*
- *Nuk mjafton pasioni*

Imamët janë për të gjithë njerëzit

Jo vetëm Islami, kjo fe madhështore, ka zbritur për të gjithë njerëzimin, por edhe Kur'ani Famëlartë është për të gjithë njerëzit, edhe i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është dërguar për të gjithë njerëzimin, po kështu, edhe Imamët e Ehli Bejtit janë për të gjithë njerëzimin, jo vetëm për një grupim njerëzish.

“Ne të kemi dërguar ty (o i Dërguar) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.”⁸

Po kështu, edhe Imamët nuk janë përcaktuar vetëm për një elitë njerëzish apo për një pjesë të fesë. Kjo është ajo që paraqitet nga biografia dhe thëniet e Imamëve. Si shembull për këtë, shohim imam Sexhadin (*Paqja qoftë mbi të!*), që i drejton hytbet e tij te të adresuarit.

Udhëheqësi, imam Khamenei na thotë: “Ajo që do të studiojmë këtu, janë thëniet e imam Sexhadt (*Paqja qoftë mbi të!*), të cituara në librin “*Tuhful Ukuli*”. Këtu shohim disa lloje metodikash, të cilat na tregojnë natyrën e të adresuarit. Një prej atyre llojeve, janë deklaratat drejtuar njerëzve në përgjithësi. Në to, dëgjuesi nuk është prej komunitetit të afërm, të veçantë të Imamt apo prej ndjekësve të tij.

8 Sure “Sebe” ajeti 28.

Biseda vazhdon kështu: *“O ju njerëz, kijen frikë Allahun dhe dijeni mirë se të gjithë ju, tek Ai do të ktheheni.”*⁹

Pastaj, Imami prek akidet islame dhe i orienton njerëzit kah domosdoshmëria e kuptimit të vërtetë e Islamit. Ai, me këtë, dëshiron t’i zgjojë njerëzit nga hutimi i injorancës dhe t’i orientojë drejt dijes islame dhe mësimeve të tij.”

9 “Tehful Ukuli”, f. 249.

E qara

A tregon e qara dobësinë e njeriut?

Nëse është kështu, mos vallë kjo do të thotë se shi'itët e Ehli Bejtit, të cilët qajnë padrejtësinë dhe vuajtjet e tyre, në mënyrë të veçantë, vuajtjen e padrejtësinë e prijësit të shehidëve dhe atyre që ishin me të në Qerbela, janë të dobët?

A do të thotë e qara, mposhtje psikologjike?

Në të vërtetë, ai që e shikon me kujdes realitetin e të qarit, do të shohë se ajo është disa llojesh, për sa u përket motivacioneve; e qara mund të jetë shenjë e dobësisë, por mund të jetë edhe shenjë e forcës. Kjo është ajo për të cilën Ehli Bejti ka bërë thirrje.

Udhëheqësi, imam Khamenei na thotë: “Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk u ndal për asnjë çast në xhihadin e tij, për ndërtimin e kuvendeve të ngushëllimit në Mina. Madje ai la amanet, që të bëhej një ceremoni ngushëllimi për të, për një periudhë kohore prej dhjetë vitesh në Mina.

“Njerëzit të mbajnë zi për mua, në Mina, për dhjetë vite.”

Kjo është vazhdimësi e xhihadit. Përse të qahet për imam Bakirin (*Paqja qoftë mbi të!*) në Mina dhe cili është qëllimi i kësaj? Përgjatë jetës së Imamëve vërejmë vendosmërinë dhe nxitjen për çështjen e të qarit. Ky miratim është dukur qartë në transmetimet që kanë përmendur

mirësinë dhe rëndësinë e të qarit për atë çfarë kishte ndodhur në Qerbela.

Ne kemi transmetime të vërteta dhe të vlerësuara në këtë aspekt. Nuk kujtoj që ai ta ketë miratuar qarjen, për një tjetër ngjarje, përveç Qerbelasë. Në kohën e imam Ridait (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ai vendosi të largohej dhe vdekja po i afrohej, mblodhi familjen e tij që ta qanin atë. Kjo lëvizje ka një argument dhe një kuptim politik, që lidhet me periudhën kohore që ka paraprirë udhëtimin dhe rënien dëshmor të tij.

Vetëm në kohën e imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*) është urdhëruar për të qarë, saqë ai, pas rënies shëhid, kishte lënë amanet dhe kishte paguar 800 derhemë nga pasuria e vet, për ta zbatuar këtë amanet në Mina.

Mina dallon nga zona e Arafatit dhe Mash'arit, madje edhe nga Meka, pasi në Mekë njerëzit janë të shpërndarë dhe secili është i angazhuar me punën e tij. Qëndrimi në Arafat është që prej kohës së sabahut e deri në kohën pas drekës dhe, kur njerëzit vijnë në Arafat, vijnë me nxitim dhe shpejtojnë të largohen, gjithashtu, pas drekës, me qëllim që të vazhdojnë veprimtaritë e tyre.

Për sa i përket Ma'sherit, qëndrimi në të nuk zgjat më shumë se disa orë dhe nuk është gjë tjetër veçse një rrugëkalim drejt Minas. Ndërsa në Mina, qëndrimi zgjat tri

net të vazhdueshme dhe të paktë janë ata njerëz që shkojnë në Mekë dhe rikthehen përsëri përgjatë këtyre tri netëve.

Shumica e njerëzve qëndrojnë tri net, pa ndërprerje, në Mina e sidomos në atë kohë, me thjeshtësinë e mjeteve në dispozicion, ku mbledhen mijëra e mijëra njerëz, që vijnë nga të katër anët e botës. Secili e di mirë se ky është vendi ideal për t'i përçuar botës çdo lloj thirrje, në veçanti në ato kohë të hershme, ku mungonin instrumentet mediatike, si radio, televizioni, gazetat, etj.

Kur një grupim qan për familjarët e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), të gjithë pyesin për shkakun e qarjes. Askush, normalisht, nuk qan për një të vdekur të zakonshëm, të thjeshtë, edhe pasi kanë kaluat qindra vite.

Shumë pyetje shtrohen në lidhje me këtë: “A është dhunuar ai? A është vrarë? Po cili e dhunoi atë? Përse u dhunua?”

Pra, çështja e të qarit, është një lëvizje e mprehtë dhe e planifikuar xhihadi.”

O ju besnikë, mos u dëshpëroni!

E qara, për të cilën Ehli Bejti ka bërë thirrje, nuk është dobësi, përkundrazi ajo është forcë, xhihad dhe demonstrim i një padrejtësie, me metodën e dëshpërimit. Ata ftojnë në dëshpërimin dhe mposhtjen e vetvetes, madje ata të ftojnë drejt shpresës dhe qetësisë për të ardhmen e ndritur, që do të qeverisë Islami i vërtetë, Islami i Muhamedit, i Aliut dhe i Ehli Bejtit.

Udhëheqësi, imam Khamenei, duke na treguar rolin e Ehli Bejtit, jo vetëm në forcimin e zemrave të shí'itëve, por edhe duke i dhënë shpresë për të ardhmen, na thotë: “Imam Bakiri distancohet nga çdo lloj përballje dhe ballafaqimi të drejtpërdrejtë me sistemin qeverisës.”

Mirëpo ky stil nuk e ka penguar Imamin të sqarojë ndjekësit e tij të singertë të “Lëvizjes së imamatit” dhe të zgjojë shpresën e madhe në zemrat e shí'itëve, që është ngritja, themelimi i sistemit politik, në kuptimin e tij të plotë hyjnor. Gjithashtu, me idetë dhe veprën e tij, imam Bakiri ka pasqyruar të ardhmen e ndritur, duke na treguar forcimin e imamatit.

Hakem bin Ajjinetu thotë: “Kur unë isha bashkë me Ebu Xhaferin dhe shtëpia, bashkë me familjen e tij po fundosej, u afrua një plak i moçëm, i mbështetur mbi

shkopin e vet. Duke qëndruar në këmbë para derës, tha: 'Selamun Alejkum, o biri i të Dërguarit të Allahut! Mëshira dhe begatia e Zotit qoftë mbi ty!'

Pastaj heshti. Ebu Xhaferri tha: 'Ue alejke selam ue rahmetullahi ue berekatuhu!'

I moshuari u kthye me fytyrë nga familjarët e shtëpisë dhe tha: 'Selam alejkum!'

Heshti, derisa të gjithë njerëzit i kthyen selamin.

Pastaj u kthye me fytyrë nga Imami dhe tha: 'O biri i të Dërguarit të Allahut, më mbaj afër teje, t'u bëfsha kurban! Pasha Zotin, unë ju dua juve dhe i dua ata që ju duan juve! Pasha Zotin, unë nuk ju dua juve dhe as ata që ju duan juve, që të shpresoj në dynja! Unë e urrej armikun tuaj dhe heq dorë prej tij! Pasha Zotin, nuk e urrej dhe nuk heq dorë prej tij, prej ndonjë padrejtësisë apo fërkimi që mund të kem pasur mes meje dhe atij!'

Pasha Zotin, unë e bëj hallall atë që ju bëni hallall dhe e bëj haram atë që ju bëni haram! A po më uron që Allahu të bëjë kurban për ty?'

Imami i tha: 'Hajde, hajde këtu!'

E uli në krah të tij dhe tha: 'O ti plak i moçëm, babait tim, Ali bin Hysejnit i erdhi një njeri dhe e pyeti për të njëjtën gjë që po më pyet ti mua. Babai im i tha: 'Nëse ti vdes, do të

jesh afër të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Aliut, Hasanit, Hysejnit dhe Ali ibn Hysejnit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Zemra jote do të kënaqet dhe do të qetësohet. Syri do të të gëzohet dhe do të shkosh me kënaqësi dhe gëzim te dy engjëjt që shkruajnë punët. Nëse ke më tepër jetë, Zoti do të ta gëzojë syrin dhe do të jesh bashkë me ne, në trungun më të lartë.’

I moshuari, i habitur shumë nga madhështia e lajmit të gëzuar, tha: ‘Po si kështu, o Ebu Xhaferr?’

Plaku përsëriti fjalët dhe tha: ‘Allahu Ekber’ – ‘Zoti është më i madhi!’

Nëse unë vdes, do të jem afër të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Aliut, Hasanit, Hysejnit dhe Ali ibn Hysejnit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Zemra ime do të kënaqet dhe do të qetësohet. Syri do të gëzohet dhe do të shkoj me kënaqësi dhe gëzim te dy engjëjt që shkruajnë punët. Nëse kam më tepër jetë, Zoti do të ma gëzojë syrin dhe do të jem bashkë me ju në trungun më të lartë?’

Pastaj i moshuari filloi të qajë me dënësë, deri sa u shtri për tokë. Ehli Bejti filloi të qajnë me dënësë, kur e pagjendjen e të moshuarit. Më pas, i moshuari ngriti kokën e tij dhe kërkoi nga Imami që t’ia afrojë dorën. Ai ia puthi dorën, e vendosi te sytë e tij dhe në faqe, pastaj e shtrëngoi fort në gjoks. U ngrit dhe u largua. Imami doli të shikonte

atë dhe tha: 'Kush dëshiron të shikojë një njeri, që është banor i Xhenetit, le të shikojë këtë njeri.'"¹⁰

Shembulli i këtyre komunikimeve e pastrojnë shpirtin e i japin shpresë zemrave që jetojnë në mjedise shqetësuese, të zhurmshme dhe represioni, duke u dhënë një vrull dhe nxitje drejt qëllimit të dëshiruar, të shëmbëllyer në themelimin e sistemit të drejtësisë islame.

¹⁰ "El Kafij", vëll. 8, f. 75-77.

Nuk mjafton vetëm pasioni

Dashuria për Ehli Bejtin është e kërkuar dhe këtë e miraton edhe Kur'ani Famëlartë: **“Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve.”**¹¹

Në të njëjtën kohë, Kur'ani Famëlartë përcakton një kuptim për dashurinë, që e tejkalon zemrën në diçka tjetër, që është ndjekja dhe vepra: **“Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”**¹²

Pra, dashuria për Allahun e Lartësuar nuk mjafton, nëse nuk ndiqet rruga e Tij dhe nuk mjafton dashuria për të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe imamët, pa ndjekur rrugën e tyre.

Udhëheqësi, imam Khamenei thotë: “Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka përshkruar pozitën e Imamit të katërt dhe rolin e tij nismëtar kështu: Pas vrasjes së imam Hysejnit, njerëzit, përveç tri personave: Ebu Khalid Kabilijit, Jahja ibn Ummu Taujilit dhe Xhubejr ibn Mutamit, u servilosën, duke u bërë femohues. Pastaj njerëzit u larguan edhe më shumë nga rruga e Allahut.

11 Sure “Eh Shura”, ajeti 23.

12 Sure “Ali Imran”, ajeti 31.

Jahja ibn Ummu Taujil hynte në xhaminë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe thoshte: “Ne ju mohuam juve dhe midis nesh dhe jush ka nisur armiqësia dhe urrejtja.”¹³

Ky transmetim na përshkruan gjendjen e shoqërisë islame, pas vrasjes së imam Hysejnit. Ajo është gjendja e mposhtjes së tmerrshme psikologjike, e cila kishte përfshirë gjithë shoqërinë islame, menjëherë pas asaj ngjarjeje. Fatkeqësia e Qarbelasë ishte tregues i rënies totale të anës shpirtërore të kësaj shoqërie, madje edhe shiiat e Ehli Bejtit iu përkulën shkencërisht kësaj bote, kënaqësisë dhe bukurisë së saj. Shembuj të tillë kanë qenë të pranishëm përgjatë gjithë historisë. Edhe në kohët tona nuk janë të paktë.

Pra, në mesin e mijëra mbështetësve shi'itë, në kohën e imam Sexhadit, vetëm tri persona qëndruan në rrugë. Vetëm tri persona nuk i trembi tmerri emevit dhe as nuk i ndëshkoi sistemi i sundimtarit. Dashuria për sigurinë dhe kërkesa për mirësitë, nuk e përkuli vendosmërinë e tyre, përkundrazi ata vazhduan t'i përgjigjen luftëtarëve të rezistencës, duke ndjekur dhe duke vazhduar me vendosmëri dhe qëndrueshmëri rrugën e tyre.

Këta nuk iu bashkuan rrymës së shoqërisë së marangozëve, ashtu siç bëjnë barinjtë që shkojnë pas

13 “Biharul Enuar”, vëll. 46, f. 144, botues “Darul Islami”.

dëshirave të qeveritarit mizor, përkundrazi, vetëm njëri prej tyre qëndroi në këmbë, Jahja bin Ummu Taujil. Ai i adresonte ndjekësit besnikë të Ehli Bejtit, në xhaminë e Medines, duke u shpallur i pafajshëm prej tyre. Ai ra dëshmor, me atë që ka thënë Ibrahim (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe ndjekësit e tij kundërshtarë të kohës së tij: **“... ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme...”**¹⁴

Jahja Ibn Ummu Taujil e lexoi këtë ajet të bekuar, përpara përkrahësve besnikë të Ehli Bejtit, nga ku shpalli ndarjen e plotë midis dy fronteve: frontin e misionarëve të angazhuar, fronti i përjetësisë në tokë dhe dekadencën e nivelin të ulët të amanetit dhe kërkesat materiale të kota. Kjo ndarje i shoqëron të gjitha thirrjet hyjnore.

Imam Sadiku, për këtë ndarje midis dy fronteve, është shprehur: *“Ai që nuk është me ne, është kundër nesh.”*, domethënë, ai që nuk bën pjesë në frontin e Teuhidit, bën pjesë në frontin e mizorëve. Nuk ka asnjë logjikë të ndërmjetme midis dy gjërave. Neutraliteti nuk ka asnjë kuptim në këtë përkatësi.

Jahja ibn Ummu Taujil, ky mysliman dhe mbrojtës i vërtetë i Ehli Bejtit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me ulërimën e tij të madhe, deklaroi ndarjen midis atyre që kënaqin veten e

14 Sure “El Mumtehine”, ajeti 4.

tyre me besnikërinë emocionale, ndërkohë që janë të ulur këmbëkryq mbi predhën e interesave personale dhe janë të mbytur në moçalin e vesveseve të tyre të ngushta dhe midis atyre që janë të angazhuar, me mendje dhe me vepra, me Imamin.”

Imami flet, gjithashtu, rreth kësaj pike, në një fjalim tjetër: “Ne sot e dimë, kuptimin e vërtetë dhe real të fjalës “vilajetun”, mirëpo më herët, në kohën e imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), këtë fjalë e komentonin me kuptimin “dashuri”. Kjo do të thotë se ata i ftonin njerëzit drejt përkujdesjes (dashurisë), domethënë dashurinë për Xhaferr ibn Muhamedin. Por a është e vërtetë kjo?

Kjo nuk është prej çështjeve të thirrjes, sepse dashuria për një individ nuk është ajo për të cilën shoqëria e thërret, duke shtuar edhe atë që, nëse e komentojmë këtë fjalë si “dashuri”, nuk mbetet asnjë kuptim për pjesën tjetër të hadithit, ku thuhet: *“Një grupim u bind dhe iu përgjigj thirrjes, kurse grupi tjetër mohoi dhe nuk iu përgjigj ftesës.”* Cili është ai që mohon dhe refuzon dashurinë për Ehli Bejtin? Një grup tjetër është frikësuar dhe ka qëndruar në këmbë.¹⁵

Nëse kjo fjalë, “vilajetun”, komentohet me fjalën “dashuri”, atëherë ajo nuk përshtatet këtu me çështjen e ndalimit. Ky është një supozim, se fjala “vilajetun” ka një kuptim tjetër veç dashurisë, që është “qeveria”.

15 “Besairu Derexhati”, f. 264.

PJESA E TRETË

IMAMËT DHE TË TJERËT

- *Imamët dhe qeveritarët*
- *Imamët dhe përkrahësit e sulltanëve*
- *Imamët dhe poetët*

Imamët dhe qeveritarët

Udhëheqësi ynë, imam Khamenei, na flet për këtë aspekt, duke iu referuar një transmetimi të rëndësishëm. Ai thotë: “Kur iu afrua vdekja imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*), la amanet që pas tij, imam të jetë i biri i tij, Muhamedi (El Bakir). Në prani të të gjithë fëmijëve dhe familjarëve, i dorëzoi një sënduk. Transmetimet thonë se ajo ishte e mbushur me dije. Gjithashtu, përmendin se brenda saj ishte arma e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Ai i tha të birit: ‘O Muhamed, ky është sënduku, prandaj shko e çoje në shtëpinë tënde.’

Pastaj tha: ‘E pra, brenda tij nuk kishte asnjë dinar apo derhem, por ishte i mbushur me dije.’.”¹⁶

Mbase ky sënduk simbolizon përgjegjësinë e udhëheqjes ideologjike dhe shkencore, pasi sënduku ishte plot me dije. Imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) i dorëzoi të birit, Muhamedit, përgjegjësinë e udhëheqjes revolucionare (arma e Profetit të Islamit).

Kështu, dorëzimi i “armës”, në aspektin e dokumenteve shkencore, djalit të tij, imam Bakirit, është një

16 “Biharul Enuar”, vëll. 46, f. 229.

tregues që Imamët nuk janë vetëm dijetarë feje, përkundrazi ata janë, gjithashtu, edhe luftëtarë. Historia e tyre na e tregon këtë fakt, edhe pse përshkrimet e luftës së tyre kanë qenë të ndryshme, sipas kushteve. Udhëheqësi merr shembull nga xihadi i imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilin shumë njerëz e konsiderojnë si Imami i lutjes, i shpëtimit dhe i dijes.

Udhëheqësi, imam Khamenei na thotë: “Në jetën e Imamit nuk kam parë kurrë diçka, që të tregojë një përballje të hapur ndaj sistemit të sundimitarit. Urtësia e kërkonte këtë gjë, sikurse e përmendëm, sepse, nëse ai do të ndërmernte qëndrime të tilla, njësoj si ato që i kemi parë në jetën e imam Musa bin Xhaferit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Imamët pas tij, përballë qeveritarëve të kohës së tij, nuk do të mundej kurrë të realizonte nxitjen e procesit të ndryshimit, që i dha imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), mundësinë e një aktiviteti më të gjerë, përkundrazi ai dhe i gjithë grupimi rreth tij do të filtrohej.

Një nga qëndrimet e tij të rralla, është mendimi i Imamit ndaj autoritetit qeverisës, por jo në standardin e përballjes, por në standardin e regjistrimit të një qëndrimi në histori.

Ka një dokument, përgjigjja që Imami ia drejtoi Abdullah ibn Mervanit, pasi i kishte dërguar mesazhin e dytë, duke e poshtëruar dhe duke e tallur, për martesën me robëreshën e tij të lirë. Me këtë lëvizje, Abdullah ibn

Mervani synonte t'ia bënte të qartë Imamit se ai është i përfshirë kudo, madje edhe në çështjet e tij personale. Gjithashtu, dëshironte t'ia kujtonte Imamit afërsinë me të, duke lakmuar pasurinë e tij. Imami, në mesazh përgjigjen e tij, ia bën shumë të qartë mendimin e Islamit për këtë çështje, duke i thënë se privilegji i besimit dhe i Islamit i anulon të gjitha privilegjet e tjera. Pastaj, me një stil shumë të mrekullueshëm eufemizmi, Imami na tregon injorancën e etërve të khalifit, madje ndoshta ai i referohet se në çfarë injorance është vetë khalifi, ku i thotë atij: 'Nuk ka faj për një person mysliman, por faji është i paditurisë.'¹⁷

Kur khalifi emevit e lexoi shprehinë e Imamit, e kuptoi mirë atë, sikurse e kuptoi edhe nënkuptimin e birit të vet, Sulejmanit, kur i tha atij: 'O prijësi i besimtarëve, është e drejtë ajo për të cilën ti je krenar ndaj Ali bin Hysejnit.'

Khalifi, me aftësinë e tij politike, si burrë shteti, i përgjigjet djalit të tij, siç thuhet se ai është më i ditur se i biri, për pasojat e përplasjes me Imamin e shi'itëve dhe i thotë: 'O biri im, mos thuaj kështu, sepse ato janë gjuhë të Beni Hashimitëve, të cilat mbyllin shkëmbin dhe fundosen nga një det. Ali ibn Hysejnit, o biri im, lartësohet aty, ku njerëzit e tjerë përulen.'¹⁸

17 "El Kafij", vëll. 5, f. 345.

18 "Tuhful Ukul", i autorit El Harr'rranij, f. 27, botoi "Xhematul Muderisijn", Kum.

Një shembull tjetër i këtyre qëndrimeve është përgjigjja e Imamit, ndaj kërkesës së paraqitur nga Abdulmelik bin Mirvani. Abdulmelikut i kishte shkuar lajmi se shpata e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është tek Imami, kështu që dërgoi dikë, që t'ia kërkojë, për t'ia dhuruar shpatën Kalifit. Ai e kërcënoi se do t'ia priste ndihmën financiare, nëse refuzonte.

Imami i shkroi këto fjalë: "S'ka asnjë dyshim se Allahu ua ka garantuar njerëzve të devotshëm furnizimin prej andej ku ata e urrejnë dhe furnizimin me risk aty ku nuk ua pret mendja: 'Allahu nuk i do mosmirënjohësit tradhtarë.'", prandaj shiko cilën meriton nga ky ajet."¹⁹

¹⁹ I njëjti burimi , f. 95.

Imamët dhe predikuesit e sulltanëve

Është e vërtetë se dijetarët janë trashëgimtarë të Profetëve, besnikë të të dërguarve, por kjo përzgjedhje ndonjëherë futet aty ku nuk është e mirëpritur që të ndiqet, sepse nuk është për njerëzit e dobët, përkundrazi, ajo bëhet si një bori për sundimtarët mendjemëdhenj.

Këta kanë ekzistuar përgjatë historisë dhe Imamët e Ehli Bejtit janë sprovuar shumë ashpër me këta njerëz. Njerëzit mahniten me pamjen e jashtme të çështjeve dhe nuk futen në brendësi të tyre dhe shpirtit të të vërtetave.

Udhëheqësi, imam Khamenei thotë: “Për sa i përket Ez Zuhrij dhe të ngjashmëve me të, Imami ka pasur një qëndrim shumë të ashpër. Këtë e shohim në mesazhin që ia ka drejtuar atij. Një pjesë mund të pyesë se deri në çfarë mase duhet të reflektojë “mesazhi” këtë qëndrim të ashpër. Mirëpo po të shohim ashpërsinë e të folurës në përmbajtjen e këtij mesazhi, që i drejtohet të njëjtit Zuhrij dhe po kështu, edhe aparatit të udhëheqësit, pa dyshim se nuk kufizohet me Muhamed bin Shehabin, përkundrazi ajo binte në dorën e njerëzve të tjerë dhe nëpërmjet gjuhëve shpërndahej dhe mbetej mësim në histori.

Po t’u hedhin një sy këtyre çështjeve, ne mund të kuptojmë përmasën e goditjes që i drejtoi shenjtërisë

djallëzore dhe fabrikimit të dijetarëve të këtij lloji. Mesazhi ishte një bisedë për Muhamed bin Shehabin, por ajo përfshiu persona të ngjashëm me të. Ajo që dihet është, se ky mesazh, kur bie në dorë të myslimanëve, e veçanërisht në dorën e shí'itëve të asaj kohe dhe përcillet dorë më dorë, çfarë rënie të prestigjit e të pozitës së tyre do të gjendej në sytë e njerëzve?

Këtu po shpalosim disa copëza të këtij mesazhi. Në fillim thotë: “Allahu na ndihmoftë neve dhe ty prej fitneve! Të mëshiroftë ty prej zjarrit!”²⁰

Pjesa e dytë e kësaj fjalie, e specifikon bisedën. Përse? Sepse çdo njeri përballlet me fitne, madje edhe imam Sexhadi, por pa rënë në grackën e tyre. Edhe Muhamed bin Shehabi u përball me fitne, por ai ra brenda. Kurse, zjarri i Xhehenemit, nuk i afrohet Imamit, më të mirit të adhuruesve, prandaj edhe Zahriu e specifikoi fjalën këtu.

Fillimi i mesazhit, më këtë mënyrë të foluri, është argument i angazhimit të Imamit me një mënyrë përbuzjeje, ofenduese.

Pastaj ai thotë: “Kam arritur në një situatë të atillë, saqë ai që ta di, duhet të të mëshirojë.”²¹

²⁰ “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 132.

²¹ I njëjti burim.

Pastaj përmend një fjali nga ajetet e Kur'anit dhe thotë se Allahu i Lartësuar kurrë nuk do të kënaqet nga mangësitë dhe të metat e tij, sepse Ai i ka urdhëruar dijetarët për t'ua sqaruar mirë të vërtetat njerëzve: **“Kujtoje (o Profet) kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t'ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai. Pastaj ata e hodhën pas shpine (premtimin) dhe e ndërruan atë me një vlerë të vogël. Eh, sa këmbim të shëmtuar që bënë ata!”**²²

Pas këtij prezantimi, ai e ngarkon atë me përgjegjësi, duke i folur shumë ashpër: “Dije mirë se gjëja më e ulët e asaj që kam mbajtur të fshehtë dhe pesha më e lehtë që kam bartur, është që i bëra shoqëri paudhësisë së të padrejtës dhe ia lehtësova atij rrugën e gabuar, kur ti iu afrove asaj rruge dhe iu përgjigje thirrjes, kur u ftove.”

Fjalja më impresionuese, në këtë paragraf, është: “A nuk është lutja e tij, kur u lut për ty? Ata të bënë ty një personalitet udhëheqës dhe t'i vërtitën ty gurgulenë e gjynaheve të tyre. Të bënë urë kalimi, duke ecur drejt belave të tyre; të bënë shkallë, duke u ngjitur drejt humbjes së tyre, duke bërë thirrje në gabimin e tyre, në përzgjedhjen e rrugës së tyre. Ata futën dyshimin te ti për dijetarët, kurse ty të imitojnë zemrat që i injorojnë ata.”

22 Sure “Ali Imran”, ajeti 187.

Pastaj thotë: “As ministrat e tyre më të mirë dhe as mbështetësit e tyre më të fortë nuk kanë bërë asgjë veç reformimit të korrupsionit të tyre.”²³

Në këtë mesazh shumë të ashpër, në shprehje, por shumë elokuent, imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) e ekspozon lëvizjen politike, e cila ka shfrytëzuar mendimin dhe diturinë.

Kështu, pra, ata që e pranuan armëpushimin e sistemit, filluan të kërkonin përsëri përgjigjen për pyetjen që mbeti dhe do të mbetet në shoqërinë islame dhe përgjatë gjithë historisë.

²³ “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 132.

Imamët dhe poetët

Poetët, në kohën e Imamëve, kanë qenë si në pozitën e medias në kohën tonë, pasi kishin një ndikim të fortë në publik. Kishte prej tyre që ishin poetë të singertë, me fjalët që thoshin për Ehli Bejtin, por kishte edhe prej atyre që ua kishte shitur fenë, personalitetin dhe gjuhën qeveritarëve mizorë e të korruptuar.

Një prej poetëve guximtarë, nga ata që thoshin fjalën e të vërtetës, edhe sikur të ishte kundër interesave të tyre, është El Ferzadiku. Udhëheqësi, imam Khamenei thotë: “Poezia e Ferzadikut mund të konsiderohet një tjetër model i sfidës, i forcës dhe i revolucionit. Jo vetëm historianët, por edhe ata që kanë qenë të pranishëm në këtë ngjarje, kanë përçuar (shkurtimisht) se, kur Hisham bin Abdul Meliku, para se të bëhej khalif, erdhi në Haxh dhe gjatë tavafit donte t’i afrohej Gurit të Zi, që ta prekte. Por një grup i madh njerëzish e pengoi atë.

Ai u përpoq disa herë ta prekte. Duke qenë i biri i khalifit, ishte i rrethuar nga shoqëruesit, por njerëzit kalonin indiferentë rrotull tij. Ai u mërziq që nuk e preku dot Gurin e Zi. U ul në një cep, duke pritur që të largoheshin njerëzit. Shoqëruesit i qëndronin rreth e rrotull.

Gjatë kësaj kohe, vjen një njeri me pamje si të asketëve. Fytyrën e kishte engjëlllore, aq sa shkëlqente si një diell në mesin e haxhinjve. Njerëzit e nderonin dhe i hapnin rrugën, që ai të kalonte mes tyre, për të shkuar te Guri i Zi. Ai shkoi, e puthi Gurin e Zi dhe iu rikthye përsëri tavafit.

Kjo i rëndoi shumë Hishamit, pasi ai ishte i biri i khalifit dhe askush nuk po e vlerësonte atë, përkundrazi, e largonin dhe e shtynin mënjanë, pastaj në krahun tjetër, shfaqet një njeri që shkon dhe e puth me qetësi Gurin e Zi.

I inatosur, pyeti se cili ishte ky njeri. Shoqëruesit e tij e njihnin atë. Ai ishte Ali bin Hysejnit. Që princi të mos zemërohej me ta, nuk i thanë gjë, sepse e dinin se ekzistonte një armiqësi midis Beni Umejeve dhe Beni Hashimitëve dhe nuk donin që t'i thoshin se ky është i madhi i familjes, që ju i keni bërë padrejtësi, kur njerëzit i demonstrojnë atij gjithë këtë dashuri dhe respekt, sepse e konsideruan këtë një lloj përçmimi dhe përbuzje për Hishamin.

Poeti i njohur El Ferzadak ishte i pranishëm dhe ishte prej atyre që e donte Ehli Bejtin. Ai e pa injorimin dhe mohimin që i bënë Hishamit dhe nderimin që i bënë Aliu ibn Hysejnit. Doli përpara dhe tha: “O ti prijës, a më lejon të të prezantoj me këtë njeri?”

Hishami tha: “Fol!”

Gjuha e Ferzadakut filloi të valëzojë poezitë më të bukura, që thuheshin për Ehli Bejtin. E nisi me këtë poezi:

*"Ky është ai që edhe stepat e njohin peshën e tij;
edhe shtëpia, edhe hallalli, edhe harami e njohin atë.*

Ky është i biri i Fatimes, nëse do ta dish mirë.

Me gjyshin e tij, Profetët e Allahut janë vulosur të vijnë."

Vargjet e kësaj poezie ishin si shpata në zemrën e Hishamit. Ai u inatos shumë me të dhe e dëboi prej aty. Nga ana tjetër, Imami i dërgoi para, por ai nuk i pranoi dhe tha: "Pasha Allahun, nuk marr prej tij para."

Ky, pra, është shembulli i poetit parimor, i cili nuk e shet as fenë dhe as gjuhën e tij.

Mirëpo ka nga ata poetë, që mbi ta zbatohet fjala e Allahut të Lartësuar: **"Poetët ndiqen nga njerëzit e humbur. Vallë, a nuk e sheh ti, që ata bredhin në çdo luginë (të fjalës së kotë), duke folur atë që kurrë s'e bëjnë?"**²⁴

Për këtë lloj poetësh, udhëheqësi, imam Khamenei thotë: "Poetët e Beni Abasitëve përpiqeshin të vërtetonin të drejtën legjitime të Beni Abasëve, duke u mbështetur tek ato argumente që vetë lakmitarët e zakonshëm të qeverisjes dhe

24 Sure "Esh Shuara", ajetet 224-226.

ata që ishin kapur pas karriges së qeverisë, i paraqisnin si të tilla. Ndërsa poetët shi'itë i qëndronin pors i një çekiç argumenteve të tyre, duke sjellë fakte për falsitetin e qeverisjes abasite në ndonjë zonë islame, e cila ishte themeluar në bazë të refuzimit të padrejtësisë, mizorisë dhe mashtrimit në dëm të ymetit islam. Për pelegrinët poetikë, midis abasitëve dhe alevitëve, ky aspekt, kishte një rëndësi të veçantë, përderisa poezia në atë kohë luante një rol të madh në vlerësimin e emocioneve dhe të mendimeve dhe për sa kohë ndikimin e jepte në bazën popullore.

Autori i librit *"El Abasijune el Auailu"*, përmend rolin e letërsisë në dy shekujt e parë dhe thotë: "Letërsia kishte një ndikim në shpirt dhe i fitonte emocionet e njerëzve ndaj këtij apo atij grupimi. Poetët dhe hatibët, në atë kohë, kanë qenë në pozitën siç janë gazetatat sot. Secili shpreh mendimin e tij politik dhe del në mbrojtje të një partie të caktuar, duke theksuar argument pas argumenti vërtetësinë e thirrjes së tij, duke përgënjeshtuar mendimet opozitare, me një folur ndikuese, me një mënyrë elokuede."²⁵

Poetët e oborrit Abasit bënë shumë përpjekje për vërtetimin e të drejtës së Abasitëve për kalifatin, duke e konsideruar lidhjen e tyre me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nëpërmjet lidhjes së xhaxhait. Këtë e argumentonin, duke thënë se trashëgimia nuk zhvendoset te fëmijët e vajzës, kur

25 Doktor Faruk Omer, *"El Abasijune el Auailu"*, f. 104.

ekzistojnë xhaxhallarët, kështu që kalifati, pas Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), është e drejtë e Abasitëve, xhaxhait të Profetit dhe pas tij, djemtë e tij, bijtë e Abasit.

Mervan ibn Ebu Hafsatu ka thënë:

*“Si mund të jetë e tillë, kur kjo nuk ekziston,
për fëmijët e vajzës, trashëgimia e xhaxhallarëve?”*

Eban ibn Abdul Hamijd El Lahikij ka thënë:

*“Djemtë e Abasit janë ata që e trashëgojnë atë.
Si mund ta ndalojë xhaxhai, djalin e xhaxhait në trashëgimi?”*

Ehli Bejti, gjithmonë i sulmonte poetët, mbështetësit dhe lavdëruesit e zullumqarëve.

Udhëheqësi, imam Khamnei thotë: “Shkolla e Ehli Bejtit mori drejtimin kah ndëshkimi i poetëve dhe dijetarëve, që e kishin shitur shpirtin e tyre, duke u përpjekur që t’ua zgjonin ndërgjegjen atyre dhe shpirtrave të ndjekësve të tyre.”

E shohim Imamin që i flet me qortim poetit Kumijt:
“E lëvdove robin e mbretit të gjithësisë?”

Ai tha: “Ajo që unë i thashë atij, o imam i udhëzimit, është e paktë. I thashë, luan, por luani është një qen; i thashë diell, por dielli është objekt pa jetë; i thashë atij, det, por deti merr jetë; i thashë, gjarpër, por gjarpri është zvarranik i vogël; i thashë, o mal, por mali është gur memec.”

Imami buzëqeshi pak dhe i recitoi Kumijt para vetes:

*“Nga një zemër jetime të mbushur me dashuri të flaktë,
nuk ka gjë tjetër veç dëshirës së zjarhtë dhe ëndrrave.”*

Me këto vargje, me një imazh artistik të shkëlqyer e të përhershëm, vendoset një kufi ndarës midis drejtimit Alevij dhe Emevij, në pozitë dhe biografi.”

PJESA E KATËRT

**PËRZGJEDHJE JETËSORE NGA EHLE
BEJTI**

Imam Aliu (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

E nderuara, Fatime Zehra (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Hasani (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Hysejini (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Ali ibn Hysejini (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Bakiri (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Sadiku (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Musa Kadhimi (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Imam Ridai (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

*Imam Xhevadi dhe ata që vijnë pas tij (Paqja e Zotit qoftë
mbi ta!)*

Imam Mehdiu (Zoti shpejtoftë ardhjen e tij!)

Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*)

Kur njeriu qëndron përballë imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) nënshtrohet dhe frikësohet. Atij personi i mjafton ajo që ka thënë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) për të: “Aliu është me të vërtetën dhe e vërteta është me Aliun. Ai sillet me të, ashtu si rrotullohet ajo.”²⁶

Në fjalët që thotë udhëheqësi, imam Khamenei, për imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), në përkujtimin e rënies së tij shehid, ndihet mall dhe dashuri, shqetësim dhe dëshpërim. Midis të tjerash, udhëheqësi thotë: “Sot është dita përkujtimore, e përhershme, e vrasjes së të bekuarit, Prijësit të besimtarëve, imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Në këtë natë dëshpëruese, të errët, në Kufe, ra dëshmor shërbëtori i popullit. Nuk mund ta imagjinoni se si ka qenë ky qytet atë natë. Të gjithë njerëzit vajtonin fatkeqësinë, pasi kishte shkuar pa kthim mbrapa ai që i ngushëllonte njerëzit, mikpritësi, bujari, dashamirësi, fisniku.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i ngushëllonte ata. Ai shkroi historinë në Uhud: “A të kënaqem me veten, kur të

²⁶ “Mizanul Hikmeti”, vëll 1, f. 138.

më thonë prijësi i besimtarëve, kur unë nuk bashkohem me ta në kohë të vështira?”²⁷

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka qenë shok i njerëzve në të gjitha dhimbjet dhe shqetësimet e tyre, duke përmendur këshillën e tij: “Pash Allahun, kujdesni për jetimët!”²⁸

Ai ka qenë pararojë, i pari që kujdesej për jetimët, sepse jetimi është ai që ka më tepër nevojë për dhembshuri, dashuri e ëmbëlsi. Ai është i privuar prej buzëqeshjes prindërore, të mbushur me dashuri, është i privuar prej përkëdhelisë së babait. Cili është ai që e mbush këtë boshllëk?

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) natën, ecte përmes shtëpive që ua njihte mirë gjendjen ekonomike, duke mbajtur mbi shpinë miell, oriz dhe vaj, për t’i ardhur në ndihmë, ndonjëherë duke u ndezur zjarrin. Sillej me dashuri me jetimët, i ulte ata në prehrin e vet, lozte me ta, me qëllim që të mos e ndienin dëshpërimin dhe mërzinë. Madhështia e imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) njihet dhe ka bërë jehonë në luftë dhe fushëbeteja, por më tepër, më e rëndësishme dhe më madhështorja, është keqardhja dhe shërbimi i tij ndaj jetimëve dhe atyre që ishin të privuar. Lotët e tij ishin lot dhembshurie dhe butësie. Atë natë, natën e njëzet, të

27 “Nehxhul Belaga”, vëll. 3, f. 72; Shpjegim i sheh Muhamed Abduh, “Darul ma’rifeti”.

“Mustadraku Sefinetil Buhar”, vëll. 10, f. 583.28

muajit Ramazan, fëmijët po e prisnin atë, ata që i mbante në prehrin e tij dhe ua përkëdhelte kokat me butësi e dashuri, i ushqente me dorën e tij. Ata e pritën gjatë atë burrë, por ai nuk erdhi atë natë. Ata e njohën se kush ishte ai. Ndoshta ju e keni dëgjuar se çfarë ndodhi, kur mjeku kërkoi qumësht për kurimin e Prijësit, me qëllim që të largonte efektin e helmit. Dhjetëra fëmijë jetimë erdhën nga të gjitha anët e Kufes, duke bartur nga një gotë qumësht secili në dorën e tij. Ata u drejtuan kah shtëpia e Imamit prijës, duke dashur ta falënderonin për mirësinë e tij, për dashurinë, kujdesin dhe dhembshurinë e tij ndaj tyre.

Mbase e keni dëgjuar, gjithashtu, për atë plakun e verbër, i cili atë natë po ankohej prej ndëshkimit të vetmisë, dhimbjes së urisë. Kur e pyetën atë, se si kishte vepruar më herët, ai u tha se një njeri vinte tek ai, e ngushëllonte dhe e ushqente me dorën e vet. Ky njeri, ishte imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ky është njeriu multidimensional. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e ka përshkruar kështu: “Pa dyshim se ai është më i sinqerti dhe më madhështori i të drejtës. Ai ndan me drejtësi të vërtetën dhe të kotën.”²⁹

Ai ishte streha dhe mbrojtësi i çdokujt që ndiente dobësi, apo nevojë. Ishte njeriu që binte pa ndjenja në

29 “Ujun Akhbaru Rida”, vëll. 2, f. 116.

mihrabin e adhurimit prej frikës së Allahut. Ishte po ky njeri udhëheqës, që nuk e duronte dot ekzistencën e ndonjë prijësi zullumqar, si Muavija. Ishte po ai që kishte kritikuar një nga prijësit, që ishte edhe prej shokëve të tij të afërt, sepse ai iu përgjigj me nxitim mikpritjes dhe banketit të thirrur nga një fisnik.

Ai ishte ruajtësi, mbrojtësi i thesarit. Që në natën e parë të marrjes në dorëzim të kalifatit, e fik llambën, që të mos shpenzojë nga pasuria e thesarit të myslimanëve, duke ua përkujtuar disa sahabëve pretendues dhe duke i paralajmëruar ata për veprimet e këqija.

Ky njeri ishte mbrojtës i njerëzve, i të drejtave të njeriut dhe respektimit të tij. Ky është Islami i vërtetë, që manifestohet me Njehsimin, në të gjitha dimensionet e gjalla, me nderimin, respektimin e njeriut dhe shpirtin e vëllazërisë ndërmjet të gjithëve.

Ai që del nga kjo rrugë, nuk konsiderohet mysliman i vërtetë, edhe nëse nuk del hapur, sepse nuk ka dyshim se zemra e tij akoma nuk ka besuar plotësisht tek Allahu dhe Kur'ani.

Ai që është rob i shpresave të mëdha, i pasioneve dhe tërhiqet kah jeta e luksit, e mbushur me zbukurime e dekoratë dhe kërkon vetëm përgjegjësi, post dhe pasuri, pëlqen pamjet e jashtme boshe, si dhe demonstroi fuqinë

dhe forcën, nuk mund të pretendojë se është kalif i imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*).

Ne e kemi për detyrë, që ta ruajmë gjithmonë këtë standard, ta thërrasim dhe ta kërkojmë rrugën e tij.”

Zonja Fatime Zahra (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Udhëheqësi, imam Khamenei na thotë se Allahu i Madhëruar ia largoi fëlliqësinë dhe e pastroi atë plotësisht.

Vërtet, çdo gjë që mund të themi për të nderuarën Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*) është shumë pak. Ne nuk dimë atë që duhet të themi dhe atë që duhet të meditojmë, për lulen Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse dimensionet ekzistenciale të kësaj hyrie njerëzore, shpirti i singertë, pasqyrë e profecisë dhe e mbrojtjes, janë të gjera, të pafundme dhe të pakonceptueshme. Nga përshkrimi i saj, njeriu hutohet.

Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*), ka pasur një pamje që nuk e lavdëronte vetëm babai i saj, të afërmit, bijtë e saj dhe rrethi i ngushtë i saj, por ajo lavdërohej edhe nga ata që nuk kishin lidhje të forta me të.

Shikojini librat që janë shkruar për Fatime Zahranë (*Paqja qoftë mbi të!*) apo rreth mënyrës së sjelljes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me këtë krijesë. Këto janë transmetuar jo vetëm nga ato që ne i kemi përmendur si bashkëshorte të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), por edhe nga të tjerë. Po përmendim transmetimin e njohur nga Aishja: “Nuk kam parë njeri më të ngjashëm me

të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në heshtje, në argumentim, në qetësi dhe në të folur se sa Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*). Kur ajo hynte tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ai ngrihej në këmbë dhe shkonte drejt saj me dashuri.”³⁰

Ky është kuptimi i fjalës “*kame ilejha*”-“*shkonte drejt saj*”. Në disa transmetime të tjera, të transmetuara, gjithashtu, nga Aishja, vjen kështu hadithi: “*Ai e uthhte atë dhe e ulte në vendin ku ishte ulur vetë.*” Kjo është e dëshmuar në biografinë e saj.

Prandaj, njeriu i logjikshëm që Zoti i Madhëruar i ka dhënë sytë të shohë, duhet të përfitojë nga jeta e këtij ylli.

Vëllezër të dashur! Nuk ka dyshim se ylli i Krijuesit të krijesës Zehra, nuk është ajo që ne e shikojmë apo e imagjinojmë, përkundrazi kjo është shumë më madhështore se kaq. Ne shikojmë nurin e personalitetit të Zahrasë, por edhe kjo është shumë më madhështore se sa kaq. Atëherë, pra, çfarë përfitojmë ne prej saj?

Ti sapo ke lexuar këtu, në njërën nga transmetimet e përmendura: “Me të vërtetë, ajo u paraqitet banorëve të qiellit, pasi ne nuk jemi asgjë para këtij nuri (drite). Engjëjt më të afërt tek Allahu i Madhëruar, në qiellin më të lartë, u verbohen sytë nga nuri i Fatime Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*).

30 “El Gadijr”, vëll 3, faqe 18.

Prandaj, edhe ne duhet të udhëzohemi me të, drejt Allahut dhe rrugës së adhurimit.

Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) e zgjodhi këtë rrugë dhe u bë Zahraja dhe ju e shihni se si Allahu i Madhëruar e ka krijuar përbërjen e saj me një baltë superiore, sepse Ai e dinte se ajo do të dalë me kokën lart nga provimi në botën lëndore.

“Ai të sprovtoi ty që para se të të krijonte dhe të pa durimtare, kur të sprovtoi.”³¹

Krijuesi i gjithësisë, i Madhërishmi, e përsosi atë baltë dhe e bëri superiore. Ky është njëri nga aspektet e jetës së Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilën ne kemi nevojë për të pastruar shpirtrat tanë.

O Allah, mos na privo ndaj dashurisë së Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe mbrojtjes së saj në dynja dhe në Ahiret, për hir të Muhamedit dhe familjes së tij. Na udhëzo ne me dritën e saj të pastër!

O Allah, shtoje, ditë pas dite, dashurinë për të në zemrat tona dhe na bëj që të vdesim me dashurinë për familjarët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Në Ditën e Kiametit na tubo rreth dashurisë së familjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).”

31 “Uesailu Shiia”, vëll. 14, f. 368.

Imam Hasani (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Historia dhe historianët i kanë bërë padrejtësi jo vetëm imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*), por edhe shumë përkrahësve të tij, pasi nuk ia kanë dhënë hakun, megjithëse Allahu i Madhëruar e pastroi plotësisht atë. Atij i mjafton që ka rënë dëshmor (*shehid*), duke u pastruar nga pislleku dhe papastërtia.

“O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.”³²

Për imam Hasanin (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), udhëheqësi, imam Khamenei na thotë: “Duke u zhvendosur në periudhën e kohës së imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*), shohim se ai mbeti i vetmuar, sapo kaluan gjashtë muaj nga marrja e përgjegjësisë së khalifatit.

Për këtë, imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) mendoi të shkojë me një pakicë fare të vogël, për të luftuar Muavijen dhe të binte shehid në betejë. Nuk është kjo ajo detyra e rëndësishme për këtë shoqëri të degjeneruar moralisht, madje, as për sa u përket gjerave personale, pasi vërtet ata nuk do të përfitojnë nga derdhja e gjakut të pastër për të ndjekur rrugën e drejtë.

32 Sure “El Ahzab”, ajeti 33.

Kështu, Muavija, me informacionet, pasuritë dhe kurthet e tij, ishte aq i aftë sa ta humbiste këtë gjakderdhje dhe efikasitetin e saj. Njerëzit, një vit pasi imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte marrë drejtimin e kalifatit, i thoshin se nuk duhej të përballej dhe të luftonte me Muavijen. Në këtë situatë, imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) mendoi se gjaku i tij do të shkojë kot, pa asnjë dobi, kështu që u rezistoi gjithë këtyre vështirësive dhe nuk e shtyu veten e vet drejt arenës së rënies dëshmor (*shhid*). Ndonjëherë, rënia shhid, për njeriun, është më e lehtë për të, se sa qëndrimi gjallë. Njerëzit që janë të zgjuar, kanë urtësi dhe botëkuptim, e perceptojnë fare mirë këtë gjë. Ndonjëherë, të qenit i gjallë në jetë, në një mjedis të lodhshëm e rraskapitës, bëhet më i vështirë, se sa të vritesh, të biesh shhid, apo të shkosh të takosh Allahun e Madhëruar. Pikërisht, këtë masë vështirësie zgjodhi imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*)."

Imam Hysejini (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*)

Të flasësh për imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*), kjo e nxeh shumë atmosferën e revolucionit dhe rënies së tij shehid. Në jetën e tij ka shumë leksione, të cilat i frymëzojnë myslimanët e sinqertë.

Udhëheqësi na flet për revolucionin e bekuar të imam Hysejnit: “Revolucioni i imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte plotësim i detyrës së ngarkuar, ishte një mënyrë shprehje e domosdoshmërisë së revolucionit për çdo mysliman që shikon shpërthimin e korrupsionit në tokën e komunitetit mysliman, aq sa i frikësohet ndryshimit të ligjeve të Islamit. Ai e ka ditur se ky revolucion do të ketë rezultat dhe nuk është kusht për të mbetur i gjallë, të mos vritesh apo të mos i ekspozohesh dënimit, ndëshkimit dhe torturës. Imam Hysejini (*Paqja qoftë mbi të!*) ndikoi dhe e kreu këtë detyrë praktikisht, duke qenë një leksion për të gjithë. Kushtet e përshtatshme mund të pihen për çdo njeri, për të kryer këtë punë përgjatë historisë.

Sigurisht, kushtet e Imamëve nuk ishin të përshtatshme, pas kohës së imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo gjë e ka një komentim, që është ekzistenca e punëve të tjera të rëndësishme që duheshin bërë, kështu që pas kësaj, nuk u poqën kushtet në komunitetin islam, deri në periudhën e fundit të Imamëve dhe fillimin e periudhës së

epokës së prapambetjes. Megjithatë, përgjatë historisë, kushte të tilla mund të piquen në vendet islame dhe tani mund të jenë pjekur kushtet në disa vende të botës islame, të gatshme për t'i ngritur në këmbë myslimanët. Nëse ngrihen në këmbë, atëherë kanë mbrojtur Islamin dhe kanë siguruar përjetësinë e tij.

Pa asnjë dyshim, imam Hysejini (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka dhënë një mësim shkencor madhështor historisë islame dhe ka siguruar përjetësinë e Islamit jo vetëm në kohën e tij, por edhe në të gjitha kohërat më pas. Kështu që kudo që ekziston një korrupsion i tillë, imam Hysejini (*Paqja qoftë mbi të!*) ka qenë i pranishëm, i gjallë, duke na mësuar mënyrën dhe punën që duhet të zbatojmë. Prandaj edhe emri i imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) duhet të mbetet i gjallë dhe ngjarja e Qerbelasë të përkujtohet përherë.

Është për të ardhur keq që vërtet leksioni i Ditës së Ashures nuk njihet siç duhet, në shumë prej shteteve islame.

E vërteta është se Dita e Ashures nuk ka të ngjashme dhe shembull me të gjitha ngjarjet dhe ndodhitë e njerëzimit.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Prijësi i besimtarëve, imam Aliu dhe

imam Hasani (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë thënë për këtë ngjarje:
*“Nuk ka ditë të ngjashme si kjo dita jote, o babai i Abdullahut!”*³³

Kjo ditë është Dita e Ashures e këto janë ditët e qarjes dhe të zisë. Nuk ka dyshim se e tërë Qerbelaja është fatkeqësi dhe zi dhe të gjitha ngjarjet e Ashures janë qarje dhe dhimbje. ”

³³ “Biharul Enuar”, vëll. 45, f. 218.

Imam Ali ibn Hysejni (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Udhëheqësi, imam Khamenei thotë: “Të flasësh dhe të shkruash për biografinë e imam Sexhadi, është e vështirë, sepse thelbi i njohjes së njerëzve me këtë imam është bërë në kohë jo të përshtashme.”

Në mendjen e shumicës së biografëve dhe analistëve ky njeri i madh e kishte izoluar plotësisht veten në adhurim dhe nuk kishte asnjë ndërhyrje në politikë. Për sa u përket atyre që nuk flasin qartë për këtë çështje, nocioni i tyre për jetën e imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është asgjë tjetër veç kësaj çështje. Ky perceptim ekziston tek epitetet që ia atribuojnë atij. Një pjesë përdor për të epitetin “i sëmuri”. Ndërkohë që sëmundja e tij nuk zgjati më shumë se disa ditë nga ngjarja e Ashures. Është e natyrshme që çdo njeri të sëmuret gjatë jetës së tij disa ditë. Sëmundja e Imami ka qenë për interesin madhor, aq sa të mos e ngarkojë këtë gjigant me mbrojtjen dhe luftën në rrugë të Allahut në ato ditë, me qëllim që në të ardhmen të mund të bartë mbi qafë peshën e rëndë të amanetit dhe imamatit.

Do të mbetet i gjallë, do të jetojë 34-35 vjet pas babait të tij, për të kaluar kohën më të vështirë të periudhës së imamatit të shi’itët.

Ju, kur shikoni jetën e mëparshme të imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*), do të gjeni lloj-lloj ngjarjesh të ndryshme, që tërheqin shikimin. Edhe pjesës tjetër të imamëve u kanë ndodhur shumë ngjarje gjatë jetës së tyre. Nëse i tubojmë së bashku biografitë e imamëve, kurrë nuk do të gjejmë të ngjashëm me biografinë e imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Udhëheqësi, imam Khamenei, na flet për filozofinë e imamatit tek imam Zejnul Abidini. Midis të tjerash thotë: “Nga të gjitha gjërat që unë i shikoj qartë si kristali e të një rëndësie të madhe, në këtë pjesë të deklaratave të imam Sexhadit (*Paqja qoftë mbi të!*), janë ato fjalë ku përmenden përvojat e mëparshme të Ehli Bejtit.

Në këtë pjesë, Imami na flet për ditët që kanë kaluar shi’itët prej udhëheqësve mizorë, si: Muavije, Jezidi dhe Mervani, apo për ngjarjet e faktuara, si: liria, Ashura, rënia dëshmor i Hixhr bin Udej dhe Reshid el Hixhrij dhe dhjetëra ngjarjeve të rënda të lëvizjes dhe revolucionit. Tani shikojeni mirë këtë fjali: “Betohem në jetën time, ju ia kthyet shpinën në ditët e shkuara të zbrazëta nga përçarjet e shumta, për të argumentuar braktisjen e djajve dhe ...”³⁴ Pra, Ju i përmendni ato përvoja dhe e dini mirë se si do të sillen me ju njerëzit e pisët dhe të korruptuar. Ata janë sundimtarët mizorë, kur

34 “El Kafij”, vëll. 8, f. 15.

t'ju kontrollojnë juve, prandaj duhet t'u qëndroni larg atyre dhe të përballeni me ta."

Në këtë fjalim, Imami e propozon qartë çështjen e imamatit.

Me fjalë të tjera, është çështja e kalifatit, e mbrojtjes së myslimanëve, e qeverisjes së njerëzve, si dhe e menaxhimit të sistemit islam.

Në atë kohë, ai nuk ishte në pozitën e Imamit, që ta mbante në publik këtë ligjëratë. Pastaj ai thotë: *"Bëni pararojë urdhrin e Allahut dhe bindjes ndaj Tij, si dhe bindjes ndaj atij që Allahu na ka obliguar t'i bindemi."*

Këtu imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) përjeton filozofinë e imamatit të shi'itët dhe njeriun që duhet t'i bindet dimensionit të Allahut. Sikur njerëzit të mendonin në këtë mënyrë, në atë periudhë kohe, do ta mësonin qartë se nuk duhet t'i bindeshin Abdulmelikut, sepse nuk lejohet dhe nuk bën që Allahu të obligojë bindjen ndaj Abdulmelikut, atij udhëheqësi mizor, me gjithë korrupsionin dhe të keqen e tij.

Pasi imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) paraqiti këtë çështje, ai ballafaqohet me një kundërpërgjigje dyshimi të lartë dhe thotë: "Mos i paraprini çështjet që u janë ngarkuar, me bindjen ndaj tiranëve, tundimin e lules së dynjasë

përpara urdhrit të Allahut dhe bindjes ndaj Tij dhe bindjes së prijesve tuaj.”³⁵

Në këtë fjalim dhe në fjalimin e mëparshëm, imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) përqendrohet në dy çështje:

Çështja e parë: Kodifikimi i mendimit islam, ringjallja e tij në mendjet e njerëzve dhe nxitja për të mësuar dijen islame.

Çështja e dytë: Mandati politik, domethënë, qeveria dhe udhëheqja e sistemit islam.

Kur imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) i përkufizon këto dy çështje, ai përkufizon sistemin e epërm dhe sistemin hyjnor islam.”

35 “El Kafij”, vëll. 8, f. 15.

Imam Bakiri (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*)

Për imam Bakirin (*Paqja qoftë mbi të!*), udhëheqësi na thotë: “Kur hynte në xhami imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), njerëzit i uleshin afër dhe e rrethonin atë, që të përfitonin prej tij. Raviu transmeton: ‘E kam parë imam Bakirin (*Paqja qoftë mbi të!*) në xhaminë e Medines dhe rrotull tij ishin banorët e Horasanit dhe të zonave të tjera, domethënë, e kishin rrethuar njerëzit nga vendet më të largëta, si Horasani. Kjo tregon se valët e përcjelljes së mesazhit e kishin përfshirë të gjithë botën dhe zemrat e njerëzve, nga vendet më të largëta, kishin filluar të afroheshin me Ehli Bejtin.’

Në një transmetim tjetër citohet “e përpinë njerëzit e Horasanit”, domethënë u ulën rrotull tij dhe e rrethuan atë. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) u mësonte atyre çështjet e hallallit dhe të haramit, saqë edhe dijetarët e mëdhenj vinin dhe merrnin mësim prej tij. Njëri prej tyre ishte Akreme, një personalitet i njohur edhe nga nxënësit e Ibn Abasit.

Kur ai (Akremetu) erdhi tek imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) për të dëgjuar hadithet e tij, e kapën të dridhurat dhe ra në prehrin e Imamit, duke thënë: “O biri i të Dërguarit të Allahut, më goditi para teje. Kurrë nuk më kishte goditur kështu para njerëzve.” Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “O ti adhurues i vogël i banorëve të Shamit, me të

vërtetë, ti je brenda shtëpive që Allahu i Madhëruar ka lejuar të ngrihet lart dhe të përmendet Emri i Tij.”³⁶

Edhe një person tjetër si Ebu Hanifja, i cili konsiderohej nga gjigantët e jurisprudencës në atë kohë, vinte për të marrë mësim nga dora e imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe pjesa tjetër e dijetarëve të kohës merrnin mësim prej tij, derisa fama e tij e diturisë arriti në skajet e botës dhe u njoftua me dijet e imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*).”

³⁶ “Biharul Enuar”, vëll. 46, f. 258.

Imam Sadiku (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*)

Udhëheqësi, imam Khamenei na thotë: “Kur filloi faza e imamatit të imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), në botën islame ishin përhapur në masë përplasjet dhe luftërat, si: në Afrikë, Horasan, Persi dhe vendet që ishin pas lumit. Kjo i shkaktoi shumë probleme Beni Umejeve. Kështu imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) arriti të përfitojë në këtë fazë nga rasti që iu dha dhe iu përqendrua imamatit të Ehli Bejtit.

Omer bin Mikdami transmeton: “Kam parë Ebu Abdullain Ditën e Arafatit, në vendqëndrim, kur ai thërriste me zë të lartë. Fliste një fjali, pastaj kthehej nga pala tjetër dhe e përsëriste e kështu me radhë. Vazhdoi kështu me katër grupime. Për secilën palë përsëriste tri herë, fjalinë: “O ju njerëz, i Dërguari i Allahut ishte vetë imam.”

Kthejeni shikimin tek i njëjti përdorim i fjalës “imam”. Kjo, për t’i kthyer njerëzit kah realiteti i imamatit dhe përhapjes së këtij mendimi, deri sa t’i bëhej pyetja vetes: A e meritojnë imamatin apo jo, këta qeveritarë të veshur me petkun e qeverisjes?

Edhe ai u thërret me zë të lartë tri herë atyre që kishte afër tij, prapa tij, nga e majta e tij, nga e djathta, plot dymbëdhjetë herë: “O ju njerëz, i Dërguari i Allahut ishte imam dhe pas tij vinte Ali bin Talibi dhe pas tij Hasani e pas

tij Hysejini dhe më pas këtyre, Ali ibn Hysejini dhe Muhamed ibn Aliu. Më pas vij unë.”

Ai i përsërit këto fjalë dymbëdhjetë herë.

Transmetuesi thotë: “Unë pyeta se ç’do të thotë fjala “*haah*” dhe tha se kuptimi i saj në gjuhë është: i biri i filanit, (unë). Është eufemizëm, duke lëvduar veten e tij, domethënë, pas Muhamed ibn Aliut unë jam imami.”

Imam Musa Kadhimi (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*)

Udhëheqësi, imam Khamenei thotë: “Ndonjëherë, fjalët e Imamëve sugjeronin çështje jo të thjeshta e të zakonshme, përkundrazi ato lidheshin me një qëllim të caktuar dhe një plan të veçantë, që ishte vetë strategjia e imamatit.

Një prej këtyre burimeve, është dialogu që u zhvillua midis imam Musa bin Xhaferr Kadhimit dhe Harun Rashidit, rreth një çështjes së “Fedekut”.

Një ditë prej ditësh, Haruni i thotë imam Kadhimit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ma përkufizo mua fedekun, që të ta kthej ty.” Me këtë veprim kishte për qëllim që të largonte ndikimin e këtij simboli (fedeku) që Ehli Bejti e paraqiste gjithmonë si argument dhe dëshmitar ndaj padrejtësisë së tyre historike. Kështu me frenimin apo përcjelljen e “fedekut”, atyre u merrej arma nga duart. Ai, gjithashtu, shpresonte që të ishte ndryshe, i veçantë në sytë e shi’itëve, nga ata sulltanë që vazhdonin të përdhunonin “fedekun”.

Në fillim, imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) u frenua për ta zbatuar këtë kërkesë, por pas këmbënguljes së Harunit, ai tha: “Unë e marr atë vetëm me kufijtë e saj. Për sa i përket kufirit të parë, ai është Adni.” Këtu ndryshoi fytyra e Harunit. Ai tha: “Ejji!!”

Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdoi përsëri: “Kufiri i dytë është Merkandi.” (kufiri lindor i tokave të qeverisjes së Harunit)

Fytyra e këtij u vrenjt komplet. Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdoi: “Kufiri i tretë është Afrika, domethënë Tunizia, ose kufiri perëndimor i vendeve.”

Transmetuesi thotë: “Fytyra e Harunit u bë e zezë sterrë dhe tha: “Ik ore!!” Në këtë çast, imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) e përfundoi fjalën e tij dhe tha: “Kufiri i katërt është shpata e detit, e cila përfshin ishujt dhe Armeninë, d.m.th. kufijtë lindorë.”

Këtu Haruni tha me ironi dhe inat: “Pra, neve, nuk na mbetet më gjë?!” U kthye drejt mexhlisit.

Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Sapo të mësova ty, se, nëse unë i përcaktoj kufijtë, nuk i kthen dot më.” Në fund të transmetimit citohet: “Në fund Haruni vendosi ta vrasë imam Kadhimin (*Paqja qoftë mbi të!*).”³⁷

Në këtë dialog shfaqet një nga kërkesat më të rëndësishme të imam Musa Kadhimit (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ishte i mjaftueshëm, aq sa Harun Reshidi urdhëroi vrasjen e tij dhe kështu u bë, sepse s’ka dyshim se kërkesat e qarta të Imamëve, në jetën e imam Bakirit, imam Sadikut dhe imam Ridait (*Paqja qoftë mbi ta!*), nëse tubohen, do të vizatohej strategjia e imamtit.”

37 “Biharul Enuar”, vëll. 29, f. 20.

Imam Ridai (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Udhëheqësi, imam Khamenei na thotë: “Formimi i bordeve të debateve me çdo person tek i cili kishte shpresën më të vogël, që të bëjë më mirë se sa Imami, ka qenë një nga procedurat e besueshme që ka praktikuar.

Kur imam Ridai (*Paqja qoftë mbi të!*) dilte superior dhe i mundte konkurrentët e tij të feve dhe të medh’hebeve të ndryshme, në të gjitha fushat e studimit, ai bëhej edhe më i famshëm me dijen dhe argumentimin e tij të prerë në çdo vend. Përballë ishte i besueshmi, i cili sillte çdo orator prej ithtarëve të argumentit, në këshillin e debatit me Imamin, me shpresën se dikush do të mund të triumfonte ndaj Imamit. Siç e dini, sa më shumë debate të bëheshin dhe sado të zgjatnin, aftësia e diturisë së imam Ridait (*Paqja qoftë mbi të!*) shtohet dhe kristalizohej edhe më shumë.

Në fund, i besueshmi u dëshpërua nga ndikimi i kësaj forme trajtimi (për rrëzimin e imam Ridait nga pozita e tij). Kështu, u përpoq të thurte kurthe për ta vrrarë Imamin, sikurse e citojnë transmetimet, nëpërmjet njerëzve që e rrethonin atë, shërbëtorët e kalifit.

Një herë, ai e burgosi imam Ridain (*Paqja qoftë mbi të!*) në burgun Sarkhas (një zonë në verilindje të Iranit), por

rezultati që mori, nuk ishte tjetër, veç rritjes së besimit të të burgosurve, në pozitën e lartë shpirtërore të imamit.

Këtu, Memuni i pafuqishëm dhe i inatosur, nuk gjeti asnjë njeri që ta ngarkojë me detyrë dhe e bëri vetë këtë fakt. Në muajin Sefer, të vitit 203 hixhri Memuni bëri krimin e tij më të madh, që nuk harrohet, vrau imam Ridain (*Paqja qoftë mbi të!*).

Imam Xhevadi dhe ata që vijnë pas tij (*Paqja e Zotit qoftë mbi ta!*)

Udhëheqësi, imam Khamenei, na thotë: “Sipas mendimit tim, sprovat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Ehli Bejti, e ka arritur kulmin që në kohën e imam Xhevadit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ka përfshirë periudhat e kohës së Imamëve që kanë ardhur pas tij.”

Imam Mehdiu (*Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!*)

Udhëheqësi, imam Khamenei, na thotë: “Çështja e imam Mehdiut është një nga çështjet më të rëndësishme në Islam dhe për këtë bashkohen në një mendim edhe grupimet e ndryshme islame, përveç shi’itëve. Ata mendojnë se origjina e imam Mehdiut është prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe ai do ta mbushë faqen e tokës me drejtësi hyjnore. Ai do të shfaqet për të ringritur dhe për të përhapur të vërtetën e fesë së Allahut.

Sikurse jomyslimanët, në krahun tjetër, besojnë për një të ardhme të shkëlqyer të njerëzimit, që do të realizohet përgjatë çështjes së mehdishipit.

Për sa i përket të veçantës, që është vetëm në akiden e shi’itëve në këtë aspekt, ajo është mosekzistenca e asnjë paqartësie në këtë çështje, sepse shi’itët e njohin me detaj këtë çështje si dhe imam Mehdiun. Ne e njohim mbrojtësin, të parin dhe Imamin tonë, zotninë e botëve. Ne e njohim babain dhe nënën e tij. E njohim historinë e lindjes dhe çdo gjë që lidhet me lindjen e tij të bekuar. Ka persona që kanë transmetuar për këtë çështje, lajme të vërteta e të dokumentuara.

Të gjitha këto çështje janë të qarta për ne dhe s'ka asnjë dyshim. Kjo do të thotë se ne jemi të sigurt për atë që e duam, që e besojmë dhe jemi të bindur se Imami ynë, i mbrojtur nga gjynahet dhe pjesa tjetër e familjes së pastër të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ekziston përgjatë kohëve të fundit midis shoqërive njerëzore. Ai sot është i pranishëm në mesin tonë, por Urtësia e Allahut kërkon që ne ta jetojmë këtë pritje të madhe, gjithashtu, edhe Imami vetë të përjetojë një pritje të tillë.

Pritjen e asaj dite që ai do të shfaqet hapur me cilësinë e tij, njësoj si rilindja e Profetëve, që përfundon me triumfin e madh përballë mohimit dhe hipokrizisë, duke e shpëtuar botën nga padrejtësia, mizoria, diferencimi, autoritarizmi dhe shfrytëzimi. Kjo ditë do të vijë dhe ky premtim do të realizohet.

Ky besim, për sa u përket shi'itëve, nëse e kanë kuptuar të vërtetën dhe a e kanë trajtuar atë siç duhet, do të jetë një burim i rrjedhshëm drite. Gjithashtu, ky besim e detyron çdo mysliman dhe besimtar ta besojë atë dhe çdo shi'it të përpiqet, mendërisht dhe praktikisht, jo vetëm të ruajë lidhjen e tij shpirtërore dhe ideologjike me Imamin e kohës së tij, por të edukojë vetveten në atë formë dhe mënyrë që gjen imam Ridai në po këtë imam të mbrojtur nga gjynahet.

Duke shtuar më tej se ky besim, ka rëndësi të madhe për të gjithë popujt, përfshi edhe popullin tonë. Një nga gjurmët dhe karakteristikat më të rëndësishme, është shpresa për të ardhmen.

Le ta dijë çdo shi'it, se shtrirja kudo e padrejtësisë dhe e mizorisë, si dhe sundimi autoritar që ekziston sot në botë, do të paloset, kur të vijë ajo ditë. Mbase mund të jetë shumë afër ajo ditë, ose mund të jetë edhe larg, por nuk ka dyshim se, sido që të jetë situata, ajo ditë do të vijë.

MBYLLJA

Anëtarët e Ehli Bejtit nuk janë njerëz që bëjnë jetën e tyre dhe me kaq mjaftohen. Gjithashtu, ata nuk janë njësoj si pjesa tjetër e njerëzve, që merren dhe u japin rëndësi gjërave të kota. Ata nuk kanë projekte të mëdha.

Ata nuk janë individë në një ymet, përkundrazi secili prej tyre ishte një komb në një njeri, prandaj ne duhet të sillemi mirë me ta, duke i trajtuar siç duhet dhe t'u japim vlerësimin që u takon.

Imamëve u është bërë padrejtësi jo vetëm nga të ashtuquajtur kalifë, por edhe nga historia, duke përjetuar izolimin dhe braktisjen e dhimbshme.

Udhëheqësi, imam Khamenei, thotë: “Izolimi i Imamëve nuk është pakësuar përgjatë kohës që ata kanë jetuar jetën e tyre, por ka vazhduar, edhe pasi ata kaluan nga kjo botë. Shkaktari i kësaj është indiferenca ndaj jetës dhe veprës së tyre.

Nuk ka dyshim se ekzistojnë shumë libra dhe botime, që kanë ruajtur pozitën dhe vlerësimin e lartë të tyre. Në përmbajtjen e tyre, ka transmetime që përshkruajnë gjendjen e Imamëve.

Ajo që unë u kam transmetuar brezave të ardhshëm, janë lajme që përshkruajnë biografinë e tyre. Por elementi i përballjes dhe i përpjekjes së vazhdueshme, që përfaqëson vijën e zgjatur e të shtrirë të Imamëve, përgjatë 250 viteve të jetës së tyre, është përmendur shumë pak në këto shkrime. Ka shkrime të tjera, që përmbajnë aspektet diturore dhe shpirtërore të biografisë së tyre.

Ne duhet ta shikojmë jetën e Imamëve si model dhe shembull për t'u ndjekur në jetën tonë, jo thjesht si kujtime me vlerë e madhështore, që kanë ndodhur përgjatë historisë.

Kjo nuk realizohet ndryshe vetëm se me përkujdesje dhe përqendrim ndaj rrugës dhe metodikës politike të këtyre gjigantëve.

Kështu, anëtarët e Ehli Bejti janë dijetarë, adhurues, që i frikësohen Allahut, luftëtarë, që urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja. Me një fjalë, ata janë plotësisht të mbrojtur nga gjynahu; janë zhytur në bindjen ndaj Allahut dhe dashurisë ndaj Tij, janë shkrirë për Islamin dhe Kur'anin. Jeta e tyre ka qenë njësoj, sikurse thotë Kur'ani: **“O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.”**³⁸

Le të bëhemi si ata. Edhe nëse nuk mundemi dhe kurrë nuk do të mund të bëhemi si ata, le të zbatojmë fjalën

38 Sure “El Ahzab”, ajeti 33.

e imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur u është përgjigjur ndjekësve të tij: *"Ju nuk keni aftësi ta bëni këtë."*

Ndjekësit e pyetën: *"Po çfarë të bëjmë, o Prijësi i besimtarëve?"*

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj: *"Më ndihmoni (më përkrahni) mua me devotshmëri, përpjekje, me dëlirësi dhe drejtësi."*³⁹

³⁹ "Biharul Enuar", vëll. 33, f. 474.

Përmbajtja

Hyrje.....	5
PJESA E PARË	
RRUGA E EHLI BEJTIT.....	9
Pikëpamje të gabuara.....	10
Pikëpamja e vërtetë.....	15
Filozofia e imamatit.....	16
Kuptimi i imamatit.....	20
Rruga e përgjithshme e Imamëve.....	24
Synimet e qeverisë islame.....	27
PJESA E DYTË	
IMAMËT DHE SHI'ITËT.....	29
Imamët janë për të gjithë njerëzit.....	30
E qara.....	32
O ju besnikë, mos u dëshpëroni!.....	35
Nuk mjafton pasioni.....	39
PJESA E TRETË	
IMAMËT DHE TË TJERËT.....	43
Imamët dhe qeveritarët.....	44
Imamët dhe përkrahësit e sulltanëve.....	48
Imamët dhe poetët.....	52
PJESA E KATËRT	
PËRZGJEDHJE JETËSORE NGA EHLI BEJTI.....	58

Imam Aliu (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	59
E nderuara, Fatime Zehra (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	64
Imam Hasani (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	67
Imam Hysejini (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	69
Imam Ali ibn Hysejini (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	72
Imam Bakiri (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	76
Imam Sadiku (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	78
Imam Musa Kadhimi (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	80
Imam Ridai (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi të!</i>).....	82
Imam Xhevadi dhe ata që vijnë pas tij (<i>Paqja e Zotit qoftë mbi ta!</i>).....	84
Imam Mehdiu (<i>Zoti shpejtoftë ardhjen e tij!</i>).....	85
Mbyllja	88
Përmbajtja	91

خطوط عامة من سيرة الأئمة (عليهم السلام)

السيد علي الخامنئي

تيرانا 2020

اسم الكتاب: خطوط عامة من سيرة الأئمة (عليهم السلام)

المؤلف: السيد علي الخامنئي

المترجم: الحاج ولنت مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا